

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

ANALIZA E.. PERFORMACËS VJETORE 2025



ADRESA: RRUGA "JORDAN MISJA", GODINA NR. 3, TIRANË
WWW.NDIHMAJURIDIKE.GOV.AL



MINISTRIA E DREJTËSISË
DIREKTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

ANALIZA E PERFORMACËS VJETORE VITI 2025

ADRESA: RRUGA "JORDAN MISJA", GODINA NR. 3, TIRANË
WWW.NDIHMAJURIDIKE.GOV.AL

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Funksionimi me kapacitet të plotë i DNJF-së.....	4
1.1	<i>Ndryshimi i strukturës së DNJF-së, me qëllim garantimin e vijimësisë së shërbimit të qendrave të ndihmës juridike parësore të hapura me mbështetjen e UNDP-së.....</i>	<i>4</i>
2	Ndihma Juridike Parësore.....	5
2.1	<i>Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore.....</i>	<i>5</i>
2.2	<i>Lidhja e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit, pranë IAL-ëve.....</i>	<i>7</i>
2.2.1	<i>Angazhimi i DNJF në kuadër të zhvillimit të trajnimeve për studentët</i>	<i>8</i>
2.2.2	<i>Zhvillimi i praktikave 3- mujore të punës pranë DNJF dhe QSHNJP.</i>	<i>9</i>
2.3	<i>Autorizimi i Organizatave Jofitimprurëse nga Ministri i Drejtësisë.</i>	<i>9</i>
2.4	<i>Të dhënat statistikore për vitin 2025, ndihma juridike parësore.</i>	<i>11</i>
2.5	<i>Një konkluzion i të dhënave statistikore, ndihma juridike parësore, me një qasje krahasuese ndër vite.....</i>	<i>17</i>
3	Ndihma juridike dytësore	21
3.1	<i>Procesi i lidhjes së kontratave me avokatët.....</i>	<i>22</i>
3.2	<i>Trajnimi i avokatëve pjesë e listës</i>	<i>22</i>
3.3	<i>Ecuria e vendimeve për pranimin e ndihmës dytësore</i>	<i>23</i>
3.4	<i>Caktimi i Avokatëve</i>	<i>26</i>
3.5	<i>Një konkluzion i të dhënave statistikore, ndihma juridike dytësore, me një qasje krahasuese ndër vite:</i>	<i>27</i>
4	Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore dhe dytësore.....	32
4.1	<i>Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore</i>	<i>32</i>
4.1.1	<i>Analizë e raporteve të monitorimit të kryera në QSHNJP</i>	<i>33</i>
4.1.2	<i>Ecuria e kryerjes së monitorimeve të qendrave</i>	<i>34</i>
4.1.3	<i>Konkluzione dhe Rekomandime nga monitorimet e QSHNJP</i>	<i>37</i>
4.2	<i>Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore</i>	<i>38</i>
5	Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike.....	39
5.1	<i>Zhvillimi dhe pjesëmarrja në takime/aktivitete ndërgjegjësuëse.....</i>	<i>40</i>
5.1.1	<i>Zhvillimi dhe pjesëmarrja e DNJF në aktivitete/ takime.....</i>	<i>40</i>
5.1.2	<i>Zhvillimi dhe pjesëmarrja e QSHNJP në aktivitete/ takime.....</i>	<i>45</i>
5.2	<i>Zhvillimi i intervistave televizive në kuadër të edukimit ligjor të publikut</i>	<i>76</i>
5.3	<i>Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror dhe vendor si dhe me organizata jofitimprurëse që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.</i>	<i>80</i>
6	Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore	81
7	Kontribute dhe raportime të DNJF-së në kuadër të proceseve strategjike.....	82

8	Raportime ndërkombëtare	83
9	Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse.	83
10	Prokurimet	84
11	Të dhëna buxhetore	86
12	Arritjet e DNJF për vitin 2025- Vështrim krahasimor 2021 - 2025.....	88
13	Plani i Punës së DNJF, për vitin 2026	101

Lista e Shkurtimeve


- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas - DNJF
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP
- Ministria e Drejtësisë - MD
- Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore – QSHNJP
- Dhoma Vendore e Avokatisë- DHVA
- Kontrolli i Lartë i Shtetit - KLSH
- Organizata Jofitimprurëse - OJF
- Qendra e Botimeve Zyrtare - QBZ
- Bashkimi Evropian - BE
- Departamenti i Administratës Publike - DAP
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike - ASPA
- Agjencia Austriake për Zhvillim – ADA
- Prezenca e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri- OSBE
- Institucione të Arsimit të Lartë- IAL

1 FUNKSIONIMI ME KAPACITET TË PLOTË I DNJF-SË

1.1 NDRYSHIMI I STRUKTURËS SË DNJF-SË, ME QËLLIM GARANTIMIN E VIJIMËSISË SË SHËRBIMIT TË QENDRAVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË HAPURA ME MBËSHTETJEN E UNDP-SË

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) realizoi një ndërhyrje të rëndësishme strukturore, e orientuar drejt garantimit të vijimësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore, veçanërisht për qendrat e shërbimit të hapura më parë me mbështetjen e UNDP-së.

Në këtë kuadër, me **Urdhrin nr. 47, datë 13.03.2025 të Kryeministrit**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 21, datë 1.3.2023, të Kryeministrit, ‘Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas’”, struktura e DNJF-së u forcua përmes shtimit të **10 (dhjetë) punonjësve** shtesë, duke e çuar numrin total të punonjësve në **49 (dyzetë e nëntë)**. Ky ndryshim strukturor krijoi bazën institucionale për integrimin e qëndrueshëm të shërbimeve të ofruara në kuadër të projekteve të mëparshme dhe kalimin e tyre në një model funksionimi të qëndrueshëm publik.



Gjatë vitit 2025, DNJF arriti të plotësojë **2 (dy) vende vakante në shërbimin civil**, konkretisht pozicionet: Specialist në Sektorin e Administrimit të Ofruesve të Ndihmës Juridike Parësore; Specialist IT në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse. Njëkohësisht, institucioni plotësoi **15 (pesëmbëdhjetë) pozicione**, marrëdhëniet e punës së të cilave rregullohen nga **Kodi i Punës**. Përkatësisht **4 (katër) pozicione punonjës mbështetës** dhe **11 (njëmbëdhjetë) Specialistë jurist** pranë Qendrave të Ofrimit të Ndihmës Juridike Parësore në: Mat, Lezhë, Pogradec,

Elbasan, Berat, Dibër, Fier, Vlorë, Kavajë, Kukës dhe Tiranë, si dhe pozicionet: Operator, Punonjës Mirëmbajtje, Sanitar dhe Nëpunës Informacioni.

Në Dhjetor 2025 DNJF pati 5 (pesë) vende vakante në shërbimin civil dhe 5 (pesë) vende vakante me Kod Pune. Shkresat drejtuar DAP për shpalljen e vendeve vakante:

- Shkresa nr. 349, datë 30.01.2025 për shpalljen e vendit vakant “Specialist IT”;
- Shkresa nr. 1409, datë 30.05.2025 për shpalljen e 3 vendeve vakante “Specialist jurist”;
- Shkresa nr. 1217/2, datë 30.05.2025 për shpalljen e vendit vakante “Përgjegjës sektori”;

Në kuadër të transparencës dhe aksesit të barabartë në informim, **të gjitha vendet vakante me Kod Pune** pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, në linkun: <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/vende-vakante/>

2 NDIHMA JURIDIKE PARËSORE

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) *punonjësit me trajnim të posaçëm;*
- b) *organizatat jofitimprurëse të autorizuara;*
- c) *klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyçe të DNJF-së. Përgjatë kësaj periudhe, DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP apo OSBE me qëllim nxitjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.

2.1 QENDRAT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE


Bazuar në kompetencën e përcaktuar në nenin 8, pika gj, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) administron, mbi bazën e urdhrit përkatës të Ministrit të Drejtësisë, Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (QSHNJP), të vendosura në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Për vitin 2025, DNJF administron 20 (njëzetë) QSHNJP në qytetet: Lezhë, Pogradec, Dibër, Kukës, Berat, Elbasan, Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Tropojë, Përmet, Pukë, Mat, Kavajë, Kurbin, Gjirokastrë, Fier, Vlorë dhe Korçë. Me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 241, datë

14.04.2025, u mundësua kalimi i QSHNJP-ve në Elbasan, Pogradec, Lezhë, Dibër, Kukës dhe Berat si pjesë e strukturës institucionale shtetërore, duke konsoliduar funksionimin e tyre të qëndrueshëm.

Mbështetja e drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit për të 20 qendrat është një ndër arritjet kryesore strategjike të institucionit, pasi garanton vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, edhe pas përfundimit të mbështetjes financiare nga organizatat ndërkombëtare partnere.

Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore



Zhvendosja e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan dhe Përmet

Gjatë vitit raportues janë ndërmarrë masa për përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe funksionale të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Elbasan dhe Përmet.

Për QSHNJP Elbasan, në vijim të kërkesës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, paraqitur me shkresën nr. 227 prot., datë 03.02.2025, si dhe pas komunikimeve institucionale me Bashkinë Elbasan dhe Prefektin e Qarkut Elbasan (shkresa nr. 653/654/655 prot., datë 26.02.2025), u arrit dakordësia për zhvendosjen e QSHNJP Elbasan pranë ambienteve të Prokurorisë pranë Gj.Sh.P. Elbasan. Kjo dakordësi u formalizua përmes shkresës nr. 656 prot., datë 26.02.2025, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit të protokolluar me nr. 656 prot., datë 03.03.2025.

Për QSHNJP Përmet, në zbatim të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për riorganizimin e ambienteve institucionale, përcjellë me shkresën nr. 460/2, datë 12.02.2025, u realizua zhvendosja e Qendrës në një ambient tjetër të dakordësuar, brenda të njëjtës godinë, duke garantuar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje.

2.2 LIDHJA E MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT ME KLINIKAT E LIGJIT, PRANË IAL-ËVE.

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, “*Klinikë ligjore*” është njësia përbërëse e një IAL, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me DNJF.

Aktualisht DNJF ka lidhur marrëveshje me 13 IAL dhe konkretisht:

1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Marin Barleti*”.
2. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;
3. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Bedër*”;
4. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin European të Tiranës;
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Aleksandër Moisiu*”, Durrës;
6. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Ismail Qemali*”, Vlorë;
7. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar “*Qiriazi*”;
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Luigj Gurakuqi*”, Shkodër;
9. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Mesdhetar*”.
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “*Luarasi*”.
11. Marrëveshje e Bashkëpunimit me Universitetin “*Epoka*”.
12. Marrëveshje e Bashkëpunimit me Universitetin “*Aleksandër Xhuvani*”, Elbasan.
13. Marrëveshje Bashkëpunimi me “*Albanian University*”.

❖ Risi për vitin 2025 përbën lidhja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Universitetin “*Albanian University*”.



2.2.1 ANGAZHIMI I DNJF NË KUADËR TË ZHVILLIMIT TË TRAJNIMEVE PËR STUDENTËT

Referuar nenit 16 të ligjit Nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, është detyrim ligjor i DNJF të bashkëpunojë me klinikat ligjore për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

*Për vitin 2025, janë trajnuar nga DNJF **293 studentë** të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Universitetit “Bedër”, “Epoka”, “Luarasi”, “Marlin Barleti”, “Mesdhetari”, Universitetit Europian të Tiranës, Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës dhe Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të cilët u pajisën me Vërtetim për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.*

Në këtë trajnim, studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, u informuan mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përftimin e ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese si dhe procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas referuar moduleve të poshtëshënuara:

- Moduli nr. 1 “Ndihma juridike parësore”;
- Moduli nr. 2 “Ndihma juridike dytësore”;
- Moduli nr. 3 “Legjislacioni specifik për kategoritë e veçanta drejtëpërdrejtë përfituese të ligjit si dhe kategoritë me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme” ;
- Moduli nr. 4 “Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane”.

Gjithashtu, u trajtuan raste praktike të lidhura ngushtësisht me problemet konkrete të institucioneve publike, kërkesat për informacion dhe ankesat, arritjet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmen.



2.2.2 ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE 3 MUJORE TË PUNËS PRANË DNJF DHE QSHNJP.

Për vitin 2025, kanë zhvilluar praktikat e punës pranë DNJF-së dhe QSHNJP Tiranë, Durrës, dhe Shkodër **94 studentë**, të cilët u pajisën dhe me vërtetimet përkatëse.



2.3 AUTORIZIMI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE NGA MINISTRI I DREJTËSISË.

Ekzistenca e një shoqërie aktive civile është tregues i demokracive funksionale që i japin hapësirë në jetën publike dhe vendimmarrje larmisë së gjerë të mendimeve, shqetësimeve dhe zgjidhjeve të ndryshme. Me anë të ndërthurjes së burimeve të ndryshme publike dhe private për të arritur misionin e tyre, organizatat e shoqërisë civile janë shpesh burim novacioni shoqëror, duke ofruar zgjidhje për çështje me interes publik. Kuadri ligjor ndërkombëtar i kushton një rëndësi thelbësore pjesëmarrjes së barabartë dhe efektive në çështjet politike dhe publike për qeverisjen demokratike. BE i ka kushtuar një rëndësi të veçantë këtij komponenti në kuadër të procesit të integritetit.

Referuar nenit 15, të ligjit 111/2017, OJF-të japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Procedura dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen në bazë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe VKM-së Nr. 55, datë 6.2.2019,

“Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

Akti i autorizimit të OJF-ve nga ana e MD, ka një afat vlefshmërie prej 2 (dy) vitesh. Që prej vitit 2020, OJF-të i janë nënshtruar procedurës së autorizimit 3 (tre) herë rradhazi dhe konkretisht: Tetor 2020-Tetor 2022; Tetor 2022-Tetor 2024; Tetor 2024-Tetor 2026.

Risi për vitin 2025 përbëjnë ndryshimet në VKMnr.55/2019, “Për autorizimin e organizatave jofitimprurëse në ofrimin e ndihmës juridike parësore”, të cilat synuan lehtësimin e procedurës së autorizimit të organizatave dhe heqjen e afatit dyvjeçar të aplikimit.

Qëllimi i ndryshimit të VKM nr. 55/2019, duke marrë në konsideratë problematikat dhe rekomandimet e evidentuara ndër vite, ishte reduktimi i barrës burokratike dhe lehtësimi i procedurave në kuadër të procesit të derregullimit. Në këtë kuadër, tashmë është parashikuar që **autorizimi të jetë pa afat vlefshmërie, duke ulur ndjeshëm kostot financiare dhe kohore për organizatat jofitimprurëse.**

Pas një korespondence të vazhdueshme gjatë gjithë vitit 2024 lidhur me ndryshimin e afatit të autorizimit (nga 2 vjet në pa afat), procesi u finalizua me miratimin e VKM nr. 14, datë 09.01.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 55, datë 6.2.2019, të Këshillit të Ministrave”.

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të parashikuara në VKM-në e sipërcituar, u krye sërish një verifikim i të dhënave, si dhe një rifreskim i dokumentacionit të përcjellë nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar në Tetor të vitit 2024. Në këtë kuadër, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas përpiloi një relacion mbi procedurën e verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore për kalimin e 14 (katërmëdhjetë) OJF-ve të autorizuar në autorizim pa afat.

Konkretisht, lista e organizatave jofitimprurëse është si vijon:

Nr.	Emërtimi i OJF-së	Selia	Email
1	Forumi i Gruas Elbasan (FGE) Dr. Ekzekutiv: Shpresa Banja.	Elbasan	forumigruaselbasan1991@gmail.com
2	Instiuti i Migracionit, Zhvillimit dhe Integritetit (IMZHI); Dr. Ekzekutiv: Enkelejt Avdyli	Tiranë	gendrainzhi@gmail.com
3	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) Dr. Ekzekutiv: Aurela Bozo.	Tiranë	avokatore2@yahoo.com
4	Qendra Psiko-Sociale Vatra Dr. Ekzekutiv: Brikena Puka.	Vlorë	info@qendravatra.org.al

5	<i>Qendra e Gruas Hapa të Lehtë</i> Dr. Ekzekutiv: Denada Shpuza.	Shkodër	gendragruashk@yahoo.com
6	<i>Qendra ALTRI</i> Dr. Ekzekutiv: Eda Noçka.	Tiranë	qendra.altri@gmail.com
7	<i>Qendra Shqiptare për Impakt Social (Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza).</i> Dr. Ekzekutiv: Iris Luarasi.	Tiranë	linjakeshillimit@gmail.com
8	<i>Shoqata “Mbrotjtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat”</i> Dr. Ekzekutiv: Artë Dyrmishi.	Berat	artadyrmishi@hotmail.com
9	<i>Shoqata “Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”</i> Dr. Ekzekutiv: Marjana Hereni.	Tiranë	m.hereni@rmsa.al
10	<i>Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin</i> Dr. Ekzekutiv: Elona Hoxha.	Tiranë	info@acpd.org.al
11	<i>Qendra “Konsumatori Shqiptar”</i> Dr. Ekzekutiv: Ersida Teliti.	Durrës	gendrakonsumatorishqiptar@gmail.com
12	<i>Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara</i> Dr. Ekzekutiv: Anjeza Puka.	Tiranë	office@qshpli.org .
13	<i>Organizata “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”</i> Dr. Ekzekutiv: Marjana Meshi.	Tiranë	mmeshi@yahoo.co.uk .
14	<i>Organizata “Shërbimi ligjor falas Tiranë” TLAS</i> Dr. Ekzekutiv: Renata Cenko	Tiranë	tlas@tlas.al

2.4 TË DHËNAT STATISTIKORE PËR VITIN 2025, NDIHMA JURIDIKE PARËSORE.

47 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike të cilët gjejnë shtrirje në 100 % të territorit të vendit:

- ✓ **20 (njëzet) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore** në Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, Tropojë, Përmet, Puka, Mati, Kavajë, Kurbin, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kukës, Korçë, Berat, Elbasan.
- ✓ **14 (katërmëdhjetë) organizata jofitimprurëse** të cilat operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Berat; Shkodër dhe Vlorë të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë
- ✓ **13 (tremëdhjetë) marrëveshje bashkëpunimi me klinikat ligjore** pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë dhe Shkodër.

✓ Platforma ONLINE (ndihma juridike parësore)- juristionline.al.

✓ Numri i gjelbër pa pagesë: 08001010.

Nr. total i rasteve të raportuara, nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore: 20 Qendra të Shërbimit, 14 OJF dhe 13 Klinika të Ligjit, për periudhën Janar – Dhjetor 2025 është 5863 raste të raportuara¹


➤ Rastet e raportuara nga ofruesit e shërbimit për muajt Janar – Dhjetor 2025, paraqiten në mënyrë tabelare dhe grafike, si vijon:

Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara	Klinikat e Ligjit pranë IAL	Total
Janar	316	200	0	516
Shkurt	250	177	0	427
Mars	179	191	2	372
Prill	250	133	0	383
Maj	261	138	0	399
Qershor	358	203	0	561
Korrik	413	147	0	560
Gusht	344	108	0	452
Shtator	422	159	0	581
Tetor	447	229	0	676
Nëntor	337	152	0	489
Dhjetor	265	182	0	447
Total	3,842	2,019	2	5,863

¹ Rastet e trajtuara në total, së bashku me Platformën Juristi Online dhe Nr. i Gjelbër, për periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë **6408**

Rastet e trajtuara nga Platforma Juristi Online për periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë 226.


Rastet e trajtuara nga Numri i Gjelbër për periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë 319.



➤ **Të dhëna statistikore të ndihmës juridike parësore, të kategorizuara sipas:**


▪ **Gjinisë:**

Lloji i ndihmës	Meshkuj	Femra	E Papërcaktuar	Nr. Total i rasteve të trajtuara – 2025
Nr. rasteve nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore	2393	3461	9	5863
Përqindje	41%	59%	0%	




▪ **Sipas natyrës së çështjes:**

Lloji i ndihmës	Civile	Penale	Administrative	E Papërcaktuar	Nr. Total i rasteve të trajtuara – 2025
<i>Nr. rasteve nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore</i>	2725	467	2595	76	5863
<i>Përqindje</i>	47%	8%	44%	1%	



▪ **Sipas Kategorive përfituese të përcaktuara në ligj:**

Lloji i ndihmës	Kategoritë pa të ardhura dhe pasuri	Kategoritë e veçanta	E papërcaktuar	Nr. Total i rasteve të trajtuara – 2025
<i>Nr raste nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike parësore</i>	3299	2259	305	5863
<i>Përqindje</i>	56%	39%	5%	



Neni 11 i Ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” parashikon në mënyrë shteruese 12 kategori të veçanta, përfitues të ndihmës juridike falas, pavarësisht të

ardhurave dhe pasurive që disponojnë. Për vitin 2025, vihet re se kategoritë me numër më të madh përfituesish, vetëm për ndihmën juridike parësore, janë:

Kategoria e veçantë	Nr.i rasteve - viti 2025
Viktima të dhunës në familje	906
Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar/ KMCAP	607
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	440
Pensionistë	851
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	175
Përfitues të ndihmës ekonomike	65
Viktima të mitur	7
Statusi i të verbrit	22
Viktima të abuzuar seksualisht	7

Kategoria e veçantë	Ndihmë Juridike Parësore	Ndihmë Juridike Dytësore	Kategoria Total
Viktima të dhunës në familje	906	170	1076
Viktima të abuzuar seksualisht	7	0	7
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	175	0	175
I mitur si kategori e veçantë	7	0	7
Të mitur në konflikt me ligjin	6	0	6
Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore	2	0	2
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor	0	0	0
Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar/ KMCAP	607	116	723
Statusi i të verbrit	22	69	91
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor	0	0	0
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor	8	0	8
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar	1	0	1
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	440	116	556
Përfitues të ndihmës ekonomike	65	0	65
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor	0	0	0
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim	8	0	8
Pensionistë	851	0	851
E papërcaktuar kategoria e veçantë përfituese	5	0	5
Nr. Total i kategorive të veçanta - Ndihmë Juridike Parësore & Dytësore – 2024	2259	471	2730
Romë/egjiptiane	424	0	424
Të mitur total ²	201	0	201

² Të mitur total nuk përfshin përllogaritjen e nr e viktimave të mitur, apo të mitur në konflikt me ligjin, si kategori e veçantë.

Lidhur me Ndhimën Juridike Parësore, vërehet se, pavarësisht faktit që numri i qendrave të ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe i organizatave jofitimprurëse të autorizuar ka mbetur i pandryshuar, gjatë periudhës **2024–2025** ka pasur një rritje të ndjeshme të volumit të çështjeve të trajtuara nga qendrat e shërbimit, si pjesë e strukturës institucionale, krahasuar me ato të trajtuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.


Në vitin **2024**, qendrat trajtuan rreth **36.8%** më shumë raste sesa organizatat jofitimprurëse, ndërsa në vitin **2025** kjo diferencë u thellua ndjeshëm, duke reflektuar një performancë dukshëm më të lartë të qendrave, të cilat trajtuan **pothuajse dyfishin e rasteve** në krahasim me organizatat jofitimprurëse.

2.5 NJË KONKLUZION I TË DHËNAVE STATISTIKORE, NDIHMA JURIDIKE PARËSORE ME NJË QASJE KRAHASUESE NDËR VITE

Në zbatim të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas është krijuar që prej vitit 2018. Ky informacion konsiston në të dhënat statistikore të numrit të ofruesve të ndihmës juridike parësore, QSHNJP, OJF dhe Klinikat e Ligjit pranë IAL-ëve, numrin e përfituesve të ndihmës juridike parësore, si dhe aktivitetet promovuese të DNJF-së, ndër vite.

➤ Ofruesit e ndihmës juridike parësore, viti 2018-2025


Ndër vite, ofruesit e sistemit të ndihmës juridike parësore kanë ardhur në rritje. **Nga 25 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore për vitin 2020 (baseline)**, DNJF në **vitin 2024 administron 47 ofrues të shërbimit (tejkalar në masën 59% objektivi i përcaktuar në Strategjinë për Ndhimën Juridike Falas (2020-2025), me një rritje prej 5% në vit të numrit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore))**. Kjo rritje pasqyrohet në formë grafike, si më poshtë:



a) Qendrat e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore

Një nga objektivat kryesore të DNJF-së ka qenë hapja e QSHNJP-ëve, si njësi të drejtëpërdrejta të ofrimit të shërbimit për individët në nevojë, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas qarqeve.


Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas, aktualisht, përvec se administron nga 1 QSHNJP në qytetin përfaqësues, kryesor të çdo qarku (12 Qendra: në Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë), administron edhe 8 QSHNJP në ato qytete, gjykatat e të cilave janë mbyllur si pasojë e riorganizimit të gjykatave, sipas hartës së re gjyqësore (Mat, Lushnjë, Permet, Pogradec, Tropojë, Kurbin, Kavajë dhe Pukë). **Nga 7 QSHNJP funksionale për vitin 2020 (baseline), Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas në vitin 2025 administron 20 QSHNJP.**



b) Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara

Referuar nenit 15, të ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, OJF-të japin shërbime të ndihmës juridike parësore, në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Që prej vitit 2020, OJF-të i janë nënshtruar procedurës së autorizimit 3 (tre) herë rradhazi dhe konkretisht: Tetor 2020-Tetor 2022; Tetor 2022-Tetor 2024; Tetor 2024-Tetor 2026. *Në vitin 2023 finalizohet për herë të parë financimi 1-vjeçar i Organizatave Jofitimprurëse, të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, ku 2 OJF fitojnë financimin nga buxheti i shtetit.*

Për vitin 2025 janë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë 14 OJF për ofrimin e ndihmës juridike parësore, që operojnë në Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Berat, Shkodër. *Një OJF fiton autorizim për herë të parë.*



c) Klinikat e Ligjit pranë IAL-eve.


Për vitin 2024 DNJF ka lidhur marrëveshje me 13 Institucione të Arsimit të Lartë. Janë nënshkruar **12** marrëveshje bashkëpunimi me Klinikat Ligjore pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, të cilat operojnë në Tiranë, Vlorë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër. *Gjatë vitit 2020 janë lidhur 9 (nëntë) marrëveshje, gjatë vitit 2021 janë lidhur 2 (dy) marrëveshje, gjatë vitit 2022 është lidhur 1 (një) marrëveshje, për vitin 2024 është lidhur 1 (një) marrëveshje dhe për vitin 2025 është lidhur 1 (një) marrëveshje*



➤ Të dhëna statistikore, mbi numrin e rasteve të ndihmës juridike parësore, 2019-2025:

- Viti 2019: 23 raste
- Viti 2020: 2427 raste
- Viti 2021: 5644 raste
- Viti 2022: 5861 raste
- Viti 2023: 7008 raste
- Viti 2024: 6220 raste
- Viti 2025: 5863 raste

(Ndhima juridike parësore: të dhëna të përlogaritura vetëm nga ofruesit: Qendrat e Shërbimit, OJF e autorizuar dhe Klinikat e Ligjit. Në këto shifra nuk përfshihen përfitues nga Platforma Juristi Online, apo Nr. i Gjellbër 0800 1010).



Përgjatë 2019-2025, është ofruar ndihmë juridike parësore për 33 046 raste

➤ Aktivitete promovuese ndër vite.

Ndihma juridike e garantuar nga shteti përbën një nga mekanizmat më thelbësorë për sigurimin e aksesit efektiv dhe të barabartë në drejtësi. Në këtë kuadër, zbatimi i ligjit nr. 111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti” nuk kufizohet vetëm në ofrimin e shërbimit ligjor, por shtrihet edhe në rritjen e ndërgjegjësimit publik, edukimin ligjor të qytetarëve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional.


Gjatë vitit **2025**, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF), në bashkëpunim me Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (QSHNJP), ka zhvilluar në total **591 aktivitete dhe takime ndërgjegjëse** në të gjithë territorin e vendit. Nga këto, **66 aktivitete** janë organizuar ose kanë pasur pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të DNJF-së, ndërsa **525 aktivitete** janë realizuar nga QSHNJP-të, të shtrira në **20 qytete** të Shqipërisë.

Aktivitetet e zhvilluara kanë përfshirë një gamë të gjerë formatesh, si takime informuese me qytetarët, aktivitete “Street Law”, trajnime me studentë dhe profesionistë të rinj, tryeza ndërinstitutionale, bashkëpunime me organizata jofitimprurëse, institucione vendore dhe qendrore, si dhe pjesëmarrje në fushata kombëtare dhe ndërkombëtare ndërgjegjëse. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar kategorive vulnerabël, përfshirë viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, fëmijët dhe të miturit, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet rome dhe egjiptiane, të moshuarit dhe personat në pamundësi ekonomike.

Shtrirja gjeografike e aktiviteteve, intensiteti i tyre dhe diversiteti i tematikave të trajtuara dëshmojnë për një angazhim të qëndrueshëm të DNJF-së dhe QSHNJP-ve në zbatimin e mandatit ligjor për rritjen e aksesit në drejtësi. Në të njëjtën kohë, këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, rritjen e besimit të publikut në sistemin e ndihmës juridike dhe orientimin më efektiv të qytetarëve drejt mekanizmave ligjorë të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Në tërësi, volumi i lartë i aktiviteteve ndërgjegjëse të zhvilluara gjatë vitit 2025 reflekton një **qasje proaktive dhe të qëndrueshme institucionale**, ku ofrimi i shërbimit ligjor shoqërohet me informim, edukim dhe fuqizim të qytetarëve, si elementë kyç për garantimin real të aksesit në drejtësi, kjo duke patur në vëmendje faktin që 6 (gjashtë) Qendra të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore nuk kanë qenë funksionale për një periudhë 3 (tre) muajore për shkak të kalimit nga buxheti i donatorëve (UNDP), në financim nga buxheti i shtetit.

Për DNJF aktivitetet ndërgjegjëse janë një pike kyçe për të krijuar lidhjen me qytetarët të cilët kanë nevojë për të përfituar ndihmë juridike falas, për këtë arsye DNJF ka hartuar një Kalendar Vjetor Aktivitetesh, miratuar me Urdhrin Nr. 16, datë 14.01.2025.



Kalendari Vjetor i Aktiviteteve për vitin 2025 përbëhet nga 3 sesione si më poshtë vijnë:

- Sesioni I – 34 aktivitete me përfaqësues të Bashkive të Vogla/ Njësive Administrative.
- Sesioni II – 20 tryeza ndërinstucionale me përfaqësues të institucioneve vendore, OJF, gjykata etj.
- Sesioni III – 21 aktivitete në kuadër të Ditëve Botërore/ Ndërkombëtare.

Ky kalendar ka si synim kryesor të arrijë me anë të aktiviteteve ndërgjegjëse të gjitha kategoritë e veçanta përfituese të ndihmës juridike falas, si edhe të shtojë promovimin e këtij shërbimi pranë njësive të qeverisjes vendore dhe institucioneve me fokus rritjen e numrit të rasteve të referuara pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

3 NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

Ndihma juridike dytësore është një nga format më thelbësore të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi. Referuar kuadrit ligjor për ndihmën juridike, përveç përfaqësimit me avokat falas, tashmë qytetarët në nevojë dhe kategoritë vulnerabël kanë mundësi të përfitojnë edhe përjashtimin nga të gjitha tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Nisur dhe nga natyra e çështjeve të ndihmës juridike, karakteri sensitiv që ato kanë, përfaqësimi me avokat falas dhe ndjekja e procesit në gjykatë është i një rëndësie thelbësore për rivendosjen në vend të të drejtave për kërkuesit e shërbimit të ndihmës juridike falas.

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e

ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të ligjit Nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

3.1 PROCESI I LIDHJES SË KONTRATAVE ME AVOKATËT

Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në shkronjën “k”, të nenit 8, të Ligjit Nr. 111/2017, DNJF lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Në muajin Janar 2025, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative, për vitin 2025.

Gjatë kësaj procedure u respektua “Parimi i Rotacionit”, si dhe të gjitha rregullat e parashikuara në Udhëzimin e Përbashkët Nr.17, datë 05.08.2020, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, duke garantuar kështu një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Pas miratimit të listës së avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, DNJF vijoi me procesin e lidhjes së kontratave me avokatët e miratuar nga DHASH për vitin 2025.

Nga 140 avokatë që nënshkruan kontratë për ofrimin e shërbimit për ndihmën juridike dytësore, aktualisht këtë shërbim e ofrojnë 132 avokatë për vitin 2025, pasi 3 avokatë janë tërhequr në mënyrë të njëanshme për shkaqe ligjore dhe për 5 (pesë) ofrues të ndihmës juridike dytësore Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka vendosur zgjidhjen e menjëhershme të kontratës për shkak se kanë refuzuar monitorimin fillestar nga strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Ndihmës Juridike, ndërsa **një ofrues nuk plotësonte** kriteret themelore për ushtrimin e shërbimit.

3.2 TRAJNIMI I AVOKATËVE PJESE E LISTËS

Me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, raportimit për sa i përket ndjekjes së çështjeve, ndërveprimit të DNJF-së me Dhomat Vendore të Avokatisë, si dhe të shkëmbimit të konsideratave, janë zhvilluar trajnime dedikuara ndihmës juridike dytësore.


Referuar nenit 9, shkronja “d”, e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku parashikohet se: “Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me DNJF”, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë ka organizuar trajnime për ofruesit e ndihmës juridike dytësore, ku janë diskutuar tema mbi kuadrin ligjor të përgjithshëm mbi ndihmën juridike, aspektet e dala nga zbatimi në praktikë i ligjit. Trajnimet i’u dedikuan temave të posaçme, të lidhura me kategoritë e veçanta përfituese të ligjit.

3.3 ECURIA E VENDIMEVE PËR PRANIMIN E NDIHMËS DYTËSORE

Nga vendimet gjyqësore me objekt kërkesën për ndihmë juridike dytësore falas, të administruara nga DNJF për vitin 2025, në total rezultojnë **924** vendime gjyqësore. Këto vendime mbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore të detajuara në formë tabelare janë si vijon:

Vendime gjyqësore me Objekt Kërkesë për Ndihmë Juridike Dytësore JANAR –DHJETOR 2025										
Lloji i kërkesës	Kërkesa për ndihmë Juridike Dytësore			Përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore			Kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore			Vendime Total
Lloji i vendimit gjyqësor	Pranim	Rrëzim	Pushim/ Kthim aktesh/ Çështje në gjykim/ Mos-kompetencë	Pranim	Rrëzim	Pushim/ Kthim aktesh/ Çështje në gjykim/ Mos-kompetencë	Pranim	Rrëzim	Pushim/ Kthim aktesh/ Çështje në gjykim/ Mos-kompetencë	
Total	57	6	2	161	7	1	643	32	15	924
	65			169			690			



Në ecurinë përgjatë muajve, mesatarja aritmetike e kërkesave të pranuar për ndihmë juridike dytësore juridike është përafërsisht 77 kërkesa në muaj. Muaji me numrin më lartë të kërkesave është muaji Tetor, me **113** vendime dhe muaji me numrin më të ulët të kërkesave është muaji Gusht me **40** vendime.




➤ Të dhëna statistikore të ndihmës juridike dytësore, të paraqitura në mënyrë grafike sipas:

- Kategorisë përfituese
- Gjinisë


Përsa i përket kategorive të personave kërkues të ndihmës juridike dytësore falas, në total evidentohet se **49% e përfituesve janë në pamundësi financiare**, si mungesë të ardhurash dhe pasurie, në **51% përfshihen kategoritë e veçanta ligjore** si viktimat të dhunës, përfitues të skemave sociale, etj. Përsa i përket gjinisë, **66% e kërkuesve rezultojnë gra** dhe **34% rezultojnë burra**.



Vendimet e gjykatave për Kërkesat për ndihmë juridike të garantuar sipas natyrës së çështjes 2025



Sipas objektit të çështjeve gjyqësore që qytetarët kanë kërkuar ndihmë juridike dytësore, evidentohet që kryesisht që janë çështje të karakterit civil. Nga totali i kërkesave për ndihmë juridike prej **924**, prej tyre **782** janë civile, ku më kryesoret janë zgjidhje martesë, njohje e viteve të punës, përfitim pensioni dhe konflikte pronësie. Ndërsa kategoritë e tjera **46** janë penale, **96** janë çështje administrative.




Përsa i përket pranimit të kërkesave të qytetarëve nga vendimet e gjykatave, evidentohet një marzh shumë i ulët i refuzimit/ kthimit të akteve/ pushim apo moskompetencë. Nga totali i kërkesave, në **45** vendime gjykatat janë shprehur për refuzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore falas.

Referuar detyrimeve dhe tagrave ligjore, Drejtoria e Ndihmës juridike Falas përsa i përket vendimeve për pranim të dhëna nga gjykatat, ka kryer ankime dhe kërkesa për ndreqje

gabimesh. Përsa i përket ankimeve, DNJF ka ankimuar për rreth **1,3% të totalit**. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kërkesave kanë ardhur për mangësi formale në vendimmarrjen e gjykatave, por edhe një pjesë zënë raste ku DNJF ka pretenduar një vendimarrje jo të saktë nga gjykatat. Konkretisht, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit në **12** raste.

Përsa i përket llojit të ndihmës juridike dytësore falas të kërkuar, nga **924** vendime në total, **65** prej tyre janë për kërkesa për të përfituar avokat, **169** për të përfituar mbulim të shpenzimeve gjyqësore dhe **690** janë kërkesa për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore, nga të cilat janë rrëzuar **45** kërkesa dhe **18** janë kthim aktesh/moskompetencë ose pushim çështje.



3.4 CAKTIMI I AVOKATËVE

Nëse analizojmë tërë vendimmarrjen e gjykatave, të përshkruar më sipër, konkretisht, rezultojnë se Dhomat Vendore të Avokatisë do të duhej të kishin komunikuar vendimmarrjen për caktim të **707 avokatëve**. Ky numër rezultojnë nga shumatorja e kërkesave për të përfituar avokat, dhe kërkesave për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore. Prej këtij totali, zbritet numri i vendimeve të marra për refuzim të kërkesës nga gjykatat.

Nga analiza e të dhënave rezulton se, Dhoma Vendore e Avokatisë Durrës ka përcjellë numrin më të lartë të vendimeve për caktimin e avokatëve për **70** raste. Ajo ndiqet nga Dhoma Vendore Dibër për **14** raste, Dhoma Vendore Berat për **14** raste dhe Dhoma Vendore Vlorë për **5** raste. Në total rezulton se nga Dhomat Vendore të Avokatisë janë përcjellë **103** vendime për caktim avokatësh, të cilat i janë komunikuar DNJF-së përgjatë vitit 2025.

Përcjellja e vendimeve për caktim avokati për vitin 2025		
Dhomat Vendore të Avokatisë		Nr. i vendimeve
1	Dhoma vendore e Avokatisë Durrës	70
2	Dhoma vendore e Avokatisë Berat	14
3	Dhoma vendore e Avokatisë Dibër	14
4	Dhoma vendore e Avokatisë Vlorë	5
Total		103

Sipas këtyre shifrave, rezulton se për më shumë se **2/3 të vendimeve gjyqësore** që kanë pranuar kërkesën e qytetarëve për avokatë, Dhomat Vendore të Avokatisë nuk kanë komunikuar vendimin e caktimit të avokatit. Në këto rrethana, ndër të tjera, bëhet e pamundur vlerësimi nëse Dhomat kanë respektuar parimin e rotacionit në vendimmarrjen e tyre.

3.5 NJË KONKLUZION I TË DHËNAVE STATISTIKORE, NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE ME NJË QASJE KRAHASUESE NDËR VITE:

I. Nr. i vendimeve gjyqësore, ndër vite, me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore.

Nga analiza krahasuese e të dhënave për periudhën **2019–2025**, evidentohet një rritje e ndjeshme dhe progresive e numrit të vendimeve gjyqësore me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, çka reflekton rritjen e aksesit të qytetarëve në drejtësi dhe konsolidimin e mekanizmit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Në mënyrë më konkrete:

- Në **vitin 2019**, janë marrë **44 vendime** nga gjykatat mbi kërkesat për ndihmë juridike të garantuar nga shteti, duke shënuar vitin bazë të analizës.
- Në **vitin 2020**, numri i vendimeve arriti në **181**, duke përfaqësuar një **rritje prej rreth 311.4%** krahasuar me vitin 2019.
- Në **vitin 2021**, janë regjistruar **849 vendime**, çka përbën një **rritje prej rreth 368.9%** krahasuar me vitin 2020, duke reflektuar një zgjerim të ndjeshëm të përdorimit të skemës së ndihmës juridike dytësore.

- Në **vitin 2022**, numri i vendimeve u rrit në **1030**, me një **rritje prej rreth 21.3%** krahasuar me vitin 2021, duke dëshmuar vijimësinë e trendit rritës, megjithëse me një ritëm më të moderuar.
- Në **vitin 2023**, janë marrë **773 vendime**, çka përfaqëson një **ulje prej rreth 25%** krahasuar me vitin 2022, rënie e cila lidhet me faktorë të ndryshëm proceduralë dhe institucionale, pa cënuar funksionimin e përgjithshëm të sistemit.
- Në **vitin 2024**, numri i vendimeve u rrit sërish në **904**, duke shënuar një **rritje prej rreth 17%** krahasuar me vitin 2023 dhe duke reflektuar rikthimin e trendit pozitiv.
- Në **vitin 2025**, janë marrë **924 vendime** nga gjykatat mbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore, me një **rritje prej rreth 2.2%** krahasuar me vitin 2024, çka tregon stabilizim të nivelit të kërkesave dhe konsolidim të mëtejshëm të skemës së ndihmës juridike.

Në tërësi, ecuria ndër vite dëshmon një zgjerim të qëndrueshëm të aksesit në ndihmën juridike dytësore dhe një rritje të ndërgjegjësimit të publikut dhe institucioneve gjyqësore për përdorimin e këtij mekanizmi si instrument kyç për garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.




II. Nr. i vendimeve gjyqësore, ndër vite, sipas natyrës së çështjes.




Përsa i përket raportit të natyrës së çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar ndihmë juridike falas, në analizën disa vjeçare shihet ruajtja e plotë e raportit. Çështjet civile shkojnë deri më 80% të totalit të çështjeve për të cilat kërkohet ndihmë juridike falas.

- Për vitin 2019, nga **44** vendime, **38** rezultojnë çështje civile, **6** penale dhe **0** administrative.
- Për vitin 2020, nga **181** vendime, **154** rezultojnë çështje civile, **13** penale dhe **14** administrative;
- Për vitin 2021 nga **849** vendime, **727** rezultojnë çështje civile, **61** penale dhe **57** administrative, 4 çështje ku nuk është përcaktuar natyra;
- Për vitin 2022 nga **1030** vendime, **691** rezultojnë çështje civile, **70** penale dhe **269** administrative;

- Për vitin 2023 nga 773 vendime, 647 rezultojnë çështje civile, 50 penale, 71 administrative dhe 5 vendime të papërcaktuara;
- Për vitin 2024 nga 904 vendime, 723 rezultojnë çështje civile, 59 penale, 120 administrative dhe 2 çështje nuk është përcaktuar natyra.
- Për vitin 2025 nga 924 vendime, 782 rezultojnë çështje civile, 46 penale, 96 administrative.




Natyra e çështjeve për të cilat është dhënë ndihmë juridike dytësore 2019- 2025					
Viti	Total	Civile	Penale	Administrative	Papërcaktuar
Viti 2019	44	38	6	0	0
Viti 2020	181	154	13	14	0
Viti 2021	849	727	61	57	4
Viti 2022	1030	691	70	269	0
Viti 2023	773	647	50	71	5
Viti 2024	904	723	59	120	2
Viti 2025	924	782	46	96	-
Vendime gjyqësore total	4705	3762	305	627	11



Të dhëna statistikore mbi likujdimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të çështjeve në themel 2025 (të përcjella për likujdim nga avokatët dhe ekspertët)			
Vendime gjyqësore të likujduara nga DNJF	Nr. i vendimeve gjyqësore të paguara (avokatë)	310	553
	Nr. i vendimeve gjyqësore të paguara (ekspertë)	243	
	Shpenzime gjyqësore		
Numri i dosjeve total të refuzuara për ekzekutim pagese			29


Likujdimi i Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë, 2025

Nr. i dosjeve të refuzuara për ekzekutim pagese
5%



Vendime gjyqësore të likujduara
95%

Totali i vendimeve gjyqësore me objekt "Kërkesë për ndihmë juridike dytësore" 2019-2025



TOTAL NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE 2019-2025 (4 705 vendime gjyqësore).

Nga të dhënat statistikore mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për çështjet në themel gjatë vitit 2025, evidentohet një rritje e ndjeshme e volumit të vendimeve të likuiduara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, si për pagesat ndaj avokatëve, ashtu edhe për ekspertët. Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë likuiduar 553 vendime gjyqësore për avokatët dhe 243 vendime gjyqësore për ekspertët, duke reflektuar një angazhim të shtuar institucional në përmbushjen në kohë të detyrimeve financiare që burojnë nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Në raport me totalin prej 4 705 vendimesh gjyqësore të ndihmës juridike dytësore për periudhën 2019–2025, volumi i likuidimeve të realizuara gjatë vitit 2025 përbën një përqindje të konsiderueshme të ekzekutimeve financiare të kryera ndër vite, çka tregon një intensifikim të punës administrative dhe financiare të DNJF-së. Ky trend dëshmon për rritjen e efikasitetit institucional në menaxhimin e dosjeve të likuidimit, përmirësimin e proceseve të brendshme dhe forcimin e kapaciteteve për përpunimin dhe ekzekutimin e pagesave në mënyrë të rregullt dhe transparente.

Për vitin 2025 në zbatim të nenit 31 të Ligjit për ndihmën juridike falas, Drejtoria ka vazhduar me procedurat e rimbursimeve, ku janë kredituar vullnetarisht nga qytetarët 7 vendime, në krahasim me vitin e kaluar kur kishim vetëm 2 vendime të rimbursuara nga apala gjyqësore, theksojmë që ky është një proces ku për një pjesë të madhe të vendimeve iu jemi drejtuar Zyrtarëve Përmbarimorë Shtetërorë për vjeljen e detyrimeve.

Në të njëjtën kohë, numri relativisht i ulët i dosjeve të refuzuara për ekzekutim pagese (29 dosje) konfirmon cilësinë e procesit të verifikimit dhe korrektësinë procedurale në administrimin e dokumentacionit të përcjellë për likuidim, duke kontribuar në rritjen e besueshmërisë së skemës së ndihmës juridike dytësore dhe në konsolidimin e rolit të DNJF-së si institucion garantuues i zbatimit efektiv të vendimeve gjyqësore.

4 MONITORIMI I CILËSISË SË OFRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE DHE DYTËSORE

4.1 MONITORIMI I CILËSISË SË OFRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE

Referuar Ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në nenin 8 të tij, përcaktohet si një ndër detyrat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas: “Zbatimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, të afuara nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët”.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve

të ndihmës juridike”, është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Për të përmbushur qëllimet e përcaktuara në ligj, Sektori i Monitorimit të Ofruesve të Ndhmës Juridike Parësore dhe Dytësore në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore, pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas që ka përgjegjësinë e kryerjes së monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme në funksion të vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Krijimi i një sistemi të ndihmës juridike falas i cili siguron akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; mirëorganizimi, mirëadministrimi dhe mirëfunksionimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike si dhe garantimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive janë disa nga qëllimet kryesore të Ligjit nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*.

Këto qëllime shërbejnë si udhëzues të mënyrës se si kryhet monitorimi i cilësisë së shërbimit, procesi i cili detajohet në Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, *“Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*.

Në përmbushje të shkronjës “I” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”* ku përcaktohet se: *“Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore”*, DNJF ka hartuar kalendarin e mbikëqyrjes për vitin 2025, në të cilin ka detajuar të gjitha monitorimet që do të kryhen përgjatë këtij viti.

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore ka vijuar me kryerjen e monitorimeve të të gjitha Qendrave, si dhe me monitorimin fillestar të avokatëve, ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

4.1.1 ANALIZË E RAPORTEVE TË MONITORIMIT TË KRYERA NË QSHNJP

Referuar parashikimeve të **metodologjisë së miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë**, vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore bazohet në **monitorimet periodike tremujore**, si dhe në **raportet mujore narrative** të përcjella nga punonjësit e Qendrave.

Për çdo raport mujor të dorëzuar, realizohet analiza e të dhënave statistikore dhe cilësore, si dhe vlerësimi i orientimit ligjor dhe i zgjidhjeve të ofruara për rastet e trajtuara. Në të njëjtën kohë, raportet mujore shërbejnë si instrument për evidentimin e problematikave praktike dhe për paraqitjen e rekomandimeve nga ana e punonjësve të Qendrave, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të ecursisë së veprimtarisë dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar për qytetarët.

Nga monitorimet e kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ka rezultuar se, në lidhje me **mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr. 111/2017**, pjesa më e madhe e Qendrave administrojnë dokumentacionin bazë të nevojshëm për përfitimin nga shërbimi i ndihmës juridike parësore, përfshirë formularët e aplikimit, dokumentacionin vërtetues për kushtet e pamundësisë ekonomike ose përkatësinë në kategori të veçanta, skedën e klientit dhe procesverbalet përkatëse. Megjithatë, u konstatua se **jo të gjitha Qendrat administrojnë dokumentacionin e plotë**, veçanërisht në lidhje me mbajtjen sistematike të formularëve dhe dokumentacionit provues, në formë shkresore ose në çdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Rekomandime:

- Të vijojë ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me **efiçencë të plotë**, duke trajtuar çdo rast në përputhje me specifikat konkrete dhe nevojat individuale të përfituesve.
- Të forcohet **bashkëpunimi ndërmjet Qendrave ekzistuese dhe qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore**, të administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, me qëllim unifikimin e praktikave dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.
- Të sigurohet **mbajtja e plotë dhe e rregullt e dokumentacionit provues**, që vërteton se qytetarit i është ofruar orientimi ligjor ose zgjidhja përkatëse për problematikën e paraqitur pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

4.1.2 ECURIA E KRYERJES SË MONITORIMEVE TË QENDRAVE

Monitorimet u ushtruan duke pasur në fokus mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe verifikuara nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë, dhe efektivitetit.

- Monitorimi dhe kontaktimi i vazhdueshëm me qendrat është një proces periodik dhe që realizohet sipas kalendarit të monitorimeve për vitin 2025.
- Pas miratimit të Kalendarit të Monitorimeve për vitin 2024 me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 79 datë 06.02.2025 *"Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Punës për monitorimin e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore"*, janë kryer Monitorimet për Qendrat e Ndhmës Juridike Parësore.
- Monitorimi i QSHNJP Pogradec realizuar sipas urdhrin nr. 106, datë 17.02.2025, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec";
- Monitorimi i QSHNJP Korçë realizuar sipas urdhrin nr. 105, datë 17.02.2025, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë";
- Monitorimi i QSHNJP Dibër realizuar sipas urdhrin nr. 107, datë 17.02.2025, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Dibër";

- Monitorimi i QSHNJP Fier realizuar sipas urdhrit nr. 136, datë 07.03.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier”;
- Monitorimi i QSHNJP Vlorë realizuar sipas urdhrit nr. 137, datë 07.03.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë”;
- Monitorimi i QSHNJP Kurbin realizuar sipas urdhrit nr. 158, datë 18.03.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kurbin”;
- Monitorimi i QSHNJP Tiranë realizuar sipas urdhrit nr. 118, datë 06.03.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë”;
- Monitorimi i QSHNJP Tropojë realizuar sipas urdhrit nr. 194, datë 04.04.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tropojë”;
- Monitorimi i QSHNJP Lushnje realizuar sipas urdhrit nr. 328, datë 20.04.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnje, si dhe verifikimi i prezencës në punë”;
- Monitorimi i QSHNJP Vlorë realizuar sipas urdhrit nr. 396, datë 13.06.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë, si dhe verifikimi i prezencës në punë”;
- Monitorimi i QSHNJP Gjirokastrë dhe Përmet realizuar sipas urdhrit nr. 415, datë 24.06.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë dhe Përmet”.
- Monitorimi i QSHNJP Tropojë realizuar sipas urdhrit nr. 571, datë 19.09.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tropojë”;
- Monitorimi i QSHNJP Kurbin realizuar sipas urdhrit nr. 605, datë 02.10.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kurbin”;
- Monitorimi i QSHNJP Mat realizuar sipas urdhrit nr. 460, datë 18.07.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Mat dhe zhvillimin e aktivitetit informues pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”;
- Monitorimi i QSHNJP Kavajë realizuar sipas urdhrit nr. 522, datë 19.08.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kavajë”.
- Monitorimi i QSHNJP Vlorë realizuar sipas urdhrit nr. 734, datë 02.12.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë, si dhe verifikimi i prezencës në punë”;
- Monitorimi i QSHNJP Korçë realizuar sipas urdhrit nr. 719, datë 20.11.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë”.
- Monitorimi i QSHNJP Elbasan realizuar sipas urdhrit nr. 718, datë 20.11.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan”.
- Monitorimi i QSHNJP Durrës realizuar sipas urdhrit nr. 733, datë 02.12.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës, si dhe verifikimi i prezencës në punë”;

- Monitorimi i QSHNJP Lezhë realizuar sipas urdhrit nr. 677, datë 06.11.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë, si dhe verifikimi i prezencës në punë”;
- Monitorimi i QSHNJP Fier realizuar sipas urdhrit nr. 679, datë 06.11.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier, si dhe verifikimi i prezencës në punë”;
- Monitorimi i QSHNJP Kavajë realizuar sipas urdhrit nr. 678, datë 06.11.2025, “Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kavajë, si dhe verifikimi i prezencës në punë”;

Kalendari i monitorimeve të kryera për vitin 2025		
	Qendrat e Shërbimit	Kryerja e Monitorimit
1	Qendra Durrës	07.02.2025; 04.12.2025
2	Qendra Tiranë	07.03.2025; 28.10.2025
3	Qendra Lushnje	27.01.2025; 20.05.2025.
4	Qendra Berat	20.10.2025-21.10.2025; 27.01.2025-28.01.2025
5	Qendra Lezhë	07.11.2025
6	Qendra Pogradec	20.02.2025-21.02.2025
7	Qendra Fier	10.11.2025-11.11.2025
8	Qendra Elbasan	06.02.2025; 27.11.2025
9	Qendra Dibër	11.06.2024- 12.06.2024
10	Qendra Shkodër	09.10.2025;11.02.2025
11	Qendra Vlorë	16.06.2025-17.06.2025; 03.12.2025-04.12.2025
12	Qendra Gjirokastrë	25.06.2025-27.06.2025
13	Qendra Kavajë	07.02.2025; 01.09.2025; 11.11.2025;
14	Qendra Kurbin	09.10.2025
15	Qendra Pukë	-
16	Qendra Tropojë	07.04.2025; 22.09.2025-24.09.2025
17	Qendra Përmet	25.06.2025-27.06.2025
18	Qendra Mat	22.07.2025-23.07.2025

19	Qendra Kukës	12.11.2025-13.11.2025
20	Qendra Korçë	19.02.2025-21.02.2025; 25.11.2025-23.11.2025;

4.1.3 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME NGA MONITORIMET E QSHNJP

Nga monitorimi i kryer pranë Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore rezulton se:

- Është regjistruar numri i rasteve të trajtuara për periudhën Janar- Dhjetor 2025, (raste të raportuara sipas Formateve TIP, të miratuara nga Ministri I Drejtësisë).
- Është mbajtur skeda e klientit për ndihmën juridike parësore (Aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër nr.531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për Miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës).
- Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmë juridike parësore, sikurse është përcaktuar në ligj. Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se punonjësit kanë mbajtur dhe plotësuar në mënyrë të rregullt dhe administrojnë formularët e ndihmës juridike parësore, sikurse parashikohet në ligj dhe aktet nënligjore.
- Është mbajtur dhe administrohet dokumentacioni provues pjesërisht që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar. Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se nga ana e punonjësve të qendrës administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës dhe që është subjekt përfitues nga ndihma juridike falas;

Rekomandime:

- Të ofrohet shërbimi i ndihmës juridike parësore me cilësi dhe eficiencë të plotë duke trajtuar çdo rast sipas formateve të miratuara me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë.
- Të mbahet gjithmonë dokumentacioni i plotë provues për përfituesit e ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore sipas përcaktimeve në ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe akteve nënligjore në funksion të tij;
- Të synohet rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrave.

Nga monitorimet e kryera gjatë vitit 2025 vërehet se ndihma juridike parësore ka konsistuar në rastet më të shumta në dhënien e ndihmës për të kërkuar ndihmë juridike parësore, më pas në rastet e dhënies së këshillimit dhe informimit në lidhje me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave. Ndhma Juridike Parësore nga Qendra përveç shërbimeve të mësipërme, ka evidentuar dhe dhënien e ndihmës juridike të hartimit dhe përpilimit të dokumenteve të nevojshme drejtuar organeve shtetërore, por ky shërbim duhet të vijojë përfshirë dhe përfaqësimin përpara organeve administrative, deri në zgjidhjen e rasteve të paraqitura nga qytetarët pranë QSHNJP.

4.2 MONITORIMI I CILËSISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Referuar hartimit dhe miratimit të Kalendarit të Monitorimeve për vitin 2024, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 43, datë 21.01.2025, protokolluar me nr.252 prot., datë 21.01.2025, monitorimi i avokatëve është kryer nëpërmjet përcjelljes së dokumentacionit nga ana e avokatëve sipas kriterëve të vlerësimit, të metodologjisë dhe procedurave të mbikëqyrjes. Ky proces ka vijuar, në zbatim të Urdhërit nr. 531, datë 25.11.2019, *“Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*,

Kontratat e shërbimit me avokatët janë lidhur në muajin Mars 2025. Për periudhën Mars 2025 – Dhjetor 2025 janë kryer monitorimet fillestare për avokatët të cilët kanë lidhur kontratë për herë të parë me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas. Për këtë periudhë janë monitoruar:

Dhoma Vendore e Avokatisë Tiranë;

Dhoma Vendore e Avokatisë Durrës;

Dhoma Vendore e Avokatisë Lushnje;

Dhoma Vendore e Avokatisë Berat;

Dhoma Vendore e Avokatisë Fier;

Dhoma Vendore e Avokatisë Vlorë;

Dhoma Vendore e Avokatisë Elbasan;

Dhoma Vendore e Avokatisë Kukës.

Dhoma Vendore e Avokatisë Shkodër.

Me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas për vitin 2025 kanë kontratë 50 ofrues të rinj të ndihmës juridike dytësore të cilët iu janë nënshtruar monitorimit fillestar. Nga 50 ofrues të ndihmës juridike dytësore monitorimin fillestar për periudhën Mars - Qershor 2025 janë monitoruar 43 ofrues të ndihmës juridike dytësore. Për avokatët të cilët nuk plotësojnë kushtet është vijuar me ndërprerjen e marrëdhënies kontraktore me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas. Dhoma Vendore e Avokatisë Korçë, Dhoma Vendore e Avokatisë Sarandë dhe Dhoma Vendore e Avokatisë Lezhë nuk ka patur ofrues të rinj për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

Në vijim të vlerësimit dhe mbikëqyrjes së ofrimit të shërbimit nga avokatët është realizuar monitorimi i avokatëve të DHVA dhe janë hartuar memot lidhur me vlerësimin e të gjitha IKV-ve, si më poshtë vijon:

- Kryer monitorimi fillestar për avokatët e rinj që kanë lidhur kontratë me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

- Monitoruar Dhoma Vendore e Avokatisë Durrës, në zbatim të Urdhërit nr. 365 datë 30.05.2025 “Për monitorimin fillestar të ofruesve të ndihmës juridike dytësore, qarku Durrës”. Monitoruar Dhoma Vendore e Avokatisë Tiranë, në zbatim të Urdhërit nr. 215 datë 11.04.2025 “Për monitorimin fillestar të ofruesve të ndihmës juridike dytësore, qarku Tiranë”.
- Monitoruar Dhoma Vendore e Avokatisë Dibër, në zbatim të Urdhërit nr. 245 datë 18.04.2025 “Për monitorimin fillestar të ofruesve të ndihmës juridike dytësore, qarku Dibër”.
- Monitoruar Dhoma Vendore e Avokatisë Lushnje, në zbatim të Urdhërit nr. 300 datë 09.05.2025 “Për monitorimin fillestar të ofruesve të ndihmës juridike dytësore, qarku Lushnje”. Monitoruar Dhoma Vendore e Avokatisë Berat, në zbatim të Urdhërit nr. 302 datë 12.05.2025 “Për monitorimin fillestar të ofruesve të ndihmës juridike dytësore, qarku Berat”.
- Monitoruar Dhoma Vendore e Avokatisë Fier, në zbatim të Urdhërit nr. 325 datë 19.05.2025 “Për monitorimin fillestar të ofruesve të ndihmës juridike dytësore, qarku Fier”.
- Monitoruar Dhoma Vendore e Avokatisë Kukës, në zbatim të Urdhërit nr. 287 datë 02.05.2025 “Për monitorimin fillestar të ofruesve të ndihmës juridike dytësore, qarku Kukës”.
- Monitoruar Dhoma Vendore e Avokatisë Shkodër në zbatim të Urdhërit nr. 413 datë 20.06.2025 “Për monitorimin fillestar të ofruesve të ndihmës juridike dytësore, qarku Shkodër”.

Është realizuar procesi i monitorimit fillestar për ofruesit e ndihmës juridike dytësore, që përbëjnë Listën e Avokatëve të Dhomave Vendore duke konstatuar dhe vlerësuar cilësinë në ofrimin e shërbimit nga ana e secilit avokat sipas IKV-ve të metodologjisë.

Nga Raportet e Vlerësimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore për periudhën Janar- Dhjetor 2025, rezulton se është konkluduar me pagesën **553 vendime gjyqësore për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dytësore, si dhe 29 raporte janë konkluduar me mospagesë.**

5 NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT MBI SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë eficiente dhe efektive.

Ligji nr.111/2017, “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, ka si qëllim të sigurojë akses të barabartë në drejtësi përmes garantimit dhe funksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas. Ky sistem garanton ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Në këtë ligj, përcaktohen detyrat dhe kompetencat e DNJF-së, disa prej të cilave janë: *mbledhja dhe analiza e informacionit mbi dhënien e ndihmës juridike dhe organizimi i fushatave për*

rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj; bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare, me Klinika Ligjore dhe me Organizata Jofitimprurëse me qëllim zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.

5.1 ZHVILLIMI DHE PJESËMARRJA NË TAKIME/AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE

5.1.1 ZHVILLIMI DHE PJESËMARRJA E DNJF NË AKTIVITETE/ TAKIME

Përgjatë vitit 2025 janë zhvilluar në total **591 takime/aktivitete ndërgjegjësuese nga DNJF dhe QSHNJP**. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka organizuar, ka qënë pjesëmarrëse në **66 takime/aktivitete ndërgjegjësuese**, të listuara në tabelën si vijon:

Nr.	Data	Aktiviteti/ Takimi
1	03.02.2025	Intervistë e Drejtorit të Përgjithshëm z. Ergys Qirici për Televizionin MCN.
2	04.02.2025	Intervistë e Drejtorit të Përgjithshëm z. Ergys Qirici për Radio Televizionin Shqiptar.
3	04.02.2025	Hedhja e shortit për avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore me praninë e Drejtorit të Përgjithshëm z. Ergys Qirici.
4	07.02.2025	Drejtori i Përgjithshëm z. Ergys Qirici ishte i ftuar në një takim në kuadër të projektit "Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri".
5	12.02.2025	Takim i Ambasadores së Austrisë znj. Monika Zach, kreun e Zyrës Rajonale të Agjencisë Austriake për Zhvillim z. David Muckenhuber dhe Drejtorit të Përgjithshëm z. Ergys Qirici me Kryetarin e Gjykatës së Elbasanit dhe QSHNJP Elbasan.
6	14.02.2025	Mbledhja e Komitetit drejtues të projektit EFLAS mbi fuqizimin e ndihmës juridike falas me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm z. Ergys Qirici.
7	18.02.2025	Takim pranë Bashkisë Berat dhe QSHNJP Berat, në kuadër të javës ndërgjegjësuese për viktimat e krimit, me zv. Ministrin e drejtësisë z. Klajd Karameta, znj. Elona Hoxha, Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë dhe znj. Patricia Pogaçe si përfaqësuese e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.
8	19.02.2025	Takim pranë Bashkisë Korçë dhe QSHNJP Korçë, në kuadër të javës ndërgjegjësuese për viktimat e krimit, me zv. Ministrin e drejtësisë z. Klajd Karameta, znj. Elona Hoxha, Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë dhe znj. Klejda Poçi si përfaqësuese e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

9	26.02.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Patricia Pogaçe ishte e ftuar në trajnimin me temë "Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit dhe siguria ushqimore".
10	05.03.2025	Trajnim me studentë të Universitetit "Luarasi" me pjesëmarrjen e Drejtoreshës së Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Patricia Pogaçe, znj. Sindi Prifti dhe znj. Helga Çela.
11	12.03.2025	U firmos marrëveshja për ambientet e reja të QSHNJP Elbasan midis Kreut të Prokurorisë së Elbasanit dhe Univeritetit "Luarasi" me pjesëmarrjen e Drejtoreshës së Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Patricia Pogaçe.
12	10.03.2025	Trajnim me studentë të FDUT me pjesëmarrjen e Përgjegjësës së Sektorit të Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Suela Qevani.
13	10.03.2025	Trajnim me studentë të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, me pjesëmarrjen e specialisteve Sindi Prifti dhe Helga Çela.
14	11.03.2025	Trajnim me studentë të Universitetit European të Tiranës, me pjesëmarrjen e specialisteve Sindi Prifti dhe Helga Çela.
15	12.03.2025	Trajnim me studentë të Universitetit "Bedër", me pjesëmarrjen e Përgjegjësës së Sektorit të Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Suela Qevani.
16	12.03.2025	Trajnim me studentë të Universitetit "Marin Barleti", me pjesëmarrjen e specialisteve Greta Nurçelli dhe Helga Çela.
17	17.03.2025	Trajnim me studentë të Universitetit "Mesdhetar", me pjesëmarrjen e Përgjegjësës së Sektorit të Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Suela Qevani dhe znj. Helga Çela.
18	19.03.2025	Trajnim me studentë të FSHS, me pjesëmarrjen e specialisteve Sindi Prifti dhe Olta Plaka.
19	21.03.2025	Trajnim me studentë të Universitetit "Epoka" me pjesëmarrjen e Përgjegjësës së Sektorit të Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Suela Qevani dhe znj. Helga Çela.
20	21.03.2025	Trajnim me studentë të Kolegjit Universitar Qiriazi me pjesëmarrjen e Drejtoreshës së Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Patricia Pogaçe dhe znj. Sindi Prifti.
21	02.04.2025	Vizitë studimore e znj. Irene Novotry, menaxhere programi pranë Agjencisë Austriake për Zhvillim, përfaqësuesit të UNDP Albania z. Francisco Roquette, Kryetarit të Prokurorisë Elbasan z. Kreshnik Ajazi dhe Drejtoreshës së Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Patricia Pogaçe.

22	04.04.2025	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mirëpret praktikantët e rinj për një praktikë tre mujore, ku do të kenë mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre ligjore dhe të kontribuojnë në garantimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët.
23	07.04.2025	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, të cilat përfitojnë financim nga buxheti i shtetit, për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore.
24	08.04.2025	U firmos marrëveshja e bashkëpunimit mes Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim. Marrëveshja u firmos nga Drejtoresha e Drejtorisë së Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore, znj. Patricia Pogaçe dhe Drejtoreshës Ekzekutive të Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, znj. Mirela Arqimandriti.
25	29.04.2025	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në bashkëpunim me prezencën e OSBE në Shqipëri, zhvilloi takime në Bashkinë Kamëz dhe Bashkinë Vorë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën për ndihmë juridike falas.
26	02.05.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Patricia Pogaçe ishte e ftuar në takimin e organizuar në kuadër të projektit "Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri".
27	06.05.2025	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, e përfaqësuar nga znj. Patricia Pogaçe, mori pjesë në konferencën me temë: "Integrimi i digjitalizimit në sistemin ligjor, psikologjik dhe arsimor. Mundësitë, sfidat dhe ndikimet në të ardhmen e shoqërisë.
28	07.05.2025	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas organizoi një tryezë pune me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe organizatat jo fitimprurëse të licensuara për ofrimin e ndihmës juridike. Takimi u zhvillua në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe shërbeu si një platformë për diskutim mbi objektivat strategjike dhe nevojat prioritare.
29	22.05.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore mori pjesë në takimin e Ekipit Tematik për Mbrotjtjen e Viktimave të Krimit, pranë Ministrisë së Drejtësisë.
30	26.05.2025	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në bashkëpunim me prezencën e OSBE në Shqipëri, zhvilloi takime në Bashkinë Peqin dhe Bashkinë Rrogozhinë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën për ndihmë juridike falas.
31	29.05.2025	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi një takim konsultues me gazetarë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të zbatimit të Direktivës së BE 2024/1069 "Për mbrotjtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrjen publike nga paditë abuzive (Anti- SLAPP)".
32	30.05.2025	Përfaqësues të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas zhvilluan trajnimin mbi ndihmën juridike falas pranë "Albanian University".

33	30.05.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore znj. Patricia Pogaçe dhe specialistë pranë DNJF ishin pjesë e kronikës së emisionit "Pyet Avokatin", në Radio Televizionin Shqiptar.
34	30.05.2025	Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ishte pjesë e prezantimit të mbajtur nga studentët e Universitetit "Epoka" në kuadër të lëndës Klinikat e Ligjit.
35	10.06.2025	Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ishte pjesë e tryezës vlerësuese të projektit "Shërbime të Përmirësuara të Ndihmës Ligjore (EQUALS)".
36	17.06.2025	Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ishte pjesë e tryzës ndërinstitutionale përkrah institucioneve të nivelit vendor dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
37	20.06.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standarteve dhe Administrimit të Ndihmës Parësore znj. Klejda Poçi, ishte e ftuar në takim në kuadër të projektit "Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri".
38	21.06.2025	Intervistë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standarteve dhe Administrimit të Ndihmës Parësore znj. Klejda Poçi, për RTSH Kukësi.
39	26.06.2025	Takim mes DNJF dhe përfaqësuesve të UNHCR Albania.
40	08.07.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore mori pjesë në takim me të rinjtë e Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri, pranë Ministrisë së Drejtësisë.
41	08.07.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore mori pjesë në takim dhe organizuar në kuadër të Ditës Kombëtare të Ndërmjetësimit.
42	13.07.2025	Intervistë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore, znj. Patricia Pogaçe, për TV "Ora News".
43	14.07.2025- 15.07.2025	Takim mes përfaqësuesve të DNJ znj. Sindi Prifti dhe znj. Helga Çela, në bashkëpunim me OSBE, pranë bashkive Fushë - Arrëz, Vau Dejës dhe Malësi e Madhe.
44	18.07.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore ishte pjesë e vizitës së ADA në QSHNJP Kukës.
45	21.07.2025	Përfaqësues të DNJF ishin pjesë e tryezës së punës me avokatët të cilët ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti.
46	22.07.2025	Përfaqësues të DNJF zhvilluan një takim informues pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë.
47	20.08.2025	DNJF në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike zhvilluan trajnimin e detyrueshëm të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

48	10.09.2025	Takim konsultues me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në bashkëpunim me organizatën Drejtësi Sociale.
49	10.09.2025	Takime informuese mbi ndihmën juridike falas në bashkitë e vogla të Delvinës dhe Finiqit, në bashkëpunim me prezencën e OSBE në Shqipëri.
50	11.09.2025	Takim informues mbi ndihmën juridike falas në bashkinë e Sarandës, në bashkëpunim me prezencën e OSBE në Shqipëri.
51	12.09.2025	U nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit mes organizatës "Drejtësi Sociale" dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.
52	18.09.2025	Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas priti në një takim Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas Kosovë.
53	19.09.2025	DNJF së bashku me përfaqësues nga Agjencia për Ndhmë Juridike Falas Kosovë zhvilluan një vizitë pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan.
54	23.09.2025	Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi një takim me "Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", ku u theksua bashkëpunimi për zhvillimin e fushatave informuese dhe trajnimet e ofruesve të ndihmës juridike parësore.
55	30.09.2025	Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas dhe Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" organizuan trajnimin me temë: "Forcimi i njohurive ligjore, të drejtave të punës dhe aftësisë së informimit për punonjësit e Qendrave të Ndhmës Juridike Falas".
56	09.11.2025	Vizitë e delegacionit Austriak në Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës me prezencën e Drejtoreshës së Përgjithshme (të komanduar) të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe.
57	10.11.2025	Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, ishte e ftuar në podcastin "Proligj" për të folur mbi ndihmën juridike falas.
58	10.11.2025	Në kuadër të bashkëpunimit me Qendrën "Të drejtat e njeriut në demokraci", u zhvillua trajnimi me temë: "Rritja e kapaciteteve të ofruesve të ndihmës juridike parësore për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje".
59	17.11.2025	Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi ndarjen e certifikatave të Praktikave të Punës së vitit 2025 me prezencën e Ministrit të Drejtësisë zotit Besfort Lamallari.
60	26.11.2025	Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Caritas Shqiptar në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare me temë:

		"Efektet e hartës së re gjyqësore mbi viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, Mësime për të ardhmen".
61	05.12.2025	Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, mori pjesë në konferencën kombëtare "Strehëzat- Një jetë e sigurtë për gratë dhe fëmijët që i mbijetojnë dhunës: Nga mbrojtja drejt fuqizimit të qëndrueshëm".
62	09.12.2025	Zëvendësministrja e Drejtësisë znj. Elona Hoxha mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.
63	16.12.2025	Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri me temë: "Të drejtat e të moshuarve në Shqipëri: Gjetjet përfundimtare mbi qasjen në shërbime dhe ndikimin e digjitalizimit".
64	18.12.2025	Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri realizuan tryezën e diskutimit mbi analizën e kuadrit ligjor mbi ndihmën juridike falas.
65	20.12.2025	Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ishte pjesë e takimit me temë: "Mekanizmi i referimit të rasteve në ndërmjetësim nga Ofruesit e Ndihmës Juridike Falas", i organizuar në kuadër të projektit "Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri" në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, CSSP-Berlin Center for Integrative Mediation, në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.
66	24.12.2025	Drejtoresha e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standarteve dhe Administrimit të Ndihmës Parësore znj. Klejda Poçi, priti në një takim Sekretare e Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës znj. Anita Kalanderi dhe përfaqësues të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas Kosovë.

5.1.2 ZHVILLIMI DHE PJESËMARRJA E QSHNJP NË AKTIVITETE/ TAKIME

Për vitin 2025 janë zhvilluar **525 takime/aktivitete ndërgjegjësuese nga QSHNJP**, të shtrira në 20 qytete të Shqipërisë, të renditura në Buletinet Informative të vendosura në vijim.

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë	
<u>Data</u>	<u>Aktiviteti</u>
14.02.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të 15–22 Shkurtit, "Java e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e viktimave të krimit".

17.02.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të 15–22 Shkurtit, “Java e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e viktimave të krimit”.
20.02.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të 15–22 Shkurtit, “Java e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e viktimave të krimit”.
21.02.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të 15–22 Shkurtit, “Java e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e viktimave të krimit”.
15.02.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të 15–22 Shkurtit, “Java e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e viktimave të krimit”.
28.02.2025	QSHNJP Tiranë mori pjesë në aktivitetin me temë “Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit dhe siguria ushqimore”.
10.03.2025	QSHNJP Tiranë zhvilloi një trajnim për studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
11.03.2025	QSHNJP Tiranë organizoi trajnim për studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Europian i Tiranës.
15.04.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet me temë “Akses në drejtësi dhe barazi para ligjit për personat me aftësi të kufizuara”.
16.04.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet “Street Law”.
23.04.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Kombëtare të Romëve.
29.04.2025	QSHNJP Tiranë zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të bashkëpunimit me përfaqësues të bashkive të vogla, me mbështetjen e OSBE-së.
13.05.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet “Street Law”.
26.05.2025	QSHNJP Tiranë zhvilloi një aktivitet me përfaqësues të bashkive të vogla, me mbështetjen e OSBE-së, në Bashkinë Peqin.
26.05.2025	QSHNJP Tiranë zhvilloi një aktivitet me përfaqësues të bashkive të vogla, me mbështetjen e OSBE-së, në Bashkinë Rrogozhinë.
04.06.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të të miturve, viktimave të agresionit”.
10.06.2025	QSHNJP Tiranë mori pjesë në workshopin për nismën “Access to Justice Action”.
19.06.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet “Street Law” në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Dhunës.
23.06.2025	QSHNJP Tiranë organizoi afishimin e posterave informuese.
24.06.2025	QSHNJP Tiranë organizoi afishimin e posterave informuese.
25.06.2025	QSHNJP Tiranë organizoi afishimin e posterave informuese.

26.06.2025	QSHNJP Tiranë organizoi afishimin e posterave informuese.
27.06.2025	QSHNJP Tiranë organizoi afishimin e posterave informuese.
09.07.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet “Street Law”.
29.07.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet “Street Law”.
04.09.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet “Street Law” në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Bamirësisë.
22.09.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet “Street Law”.
23.09.2025	QSHNJP Tiranë organizoi takim me OJF-në Qendra “Barazi dhe Përfshirje”.
02.10.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve.
03.10.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Pa Dhunë.
06.10.2025	QSHNJP Tiranë organizoi takim me OJF-në Qendra “CEDI”.
29.10.2025	QSHNJP Tiranë organizoi pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Qendra “Streha”.
30.10.2025	QSHNJP Tiranë organizoi aktivitet informues në gjimnazin “Sander Prosi”.
07.11.2025	QSHNJP Tiranë mori pjesë në trajnimin me temë “Rritja e kapaciteteve të ofruesve të ndihmës juridike parësore për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”.
12.11.2025	QSHNJP Tiranë mori pjesë në trajnimin me temë “Të drejtat e konsumatorit dhe kategoritë që preken”.
23.12.2025	QSHNJP Tiranë zhvilloi takimin me temë: “Forcimi i të Drejtave të Punës dhe Barazisë Gjinore”.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës	
<u>Data</u>	<u>Aktiviteti</u>
23.01.2025	QSHNJP Durrës mori pjesë në trajnimin për forcimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të institucioneve lokale mbi parandalimin e abuzimit të burimeve shtetërore për përfitim elektoral.

24.01.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas”.
24.02.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e viktimave të krimit.
27.02.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e viktimave të krimit.
21.03.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eleminimin e Diskriminimit Racial.
27.03.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për të Vërtetën lidhur me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe për dinjitetin e viktimave.
11.04.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve.
09.05.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.
15.05.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Kombëtare të Familjes.
20.05.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas” në bashkitë e vogla, Bashkia Sukth.
20.05.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas” në bashkitë e vogla, Bashkia Shijak.
23.05.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas”.
26.05.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas”.
03.06.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm dhe Viktima të Agresionit.
09.06.2025	QSHNJP Durrës mori pjesë në hartimin e manualit në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas”.
17.06.2025	QSHNJP Durrës zhvilloi një aktivitet në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor dhe referimit të rasteve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
25.06.2025	QSHNJP Durrës mori pjesë në hartimin e manualit në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas”.
27.06.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas” në bashkitë e vogla, Njësia Administrative Manëz.

27.06.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave si dhe Ditës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në Mbështetjen e Viktimave të Torturës.
04.07.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas”.
10.07.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë “Promovimi i ndihmës juridike falas”.
23.09.2025	QSHNJP Durrës mori pjesë në Tryezën e Konsultimit Publik me gjyqtarë dhe prokurorë mbi Kodin e ri Penal.
10.10.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.
21.10.2025	QSHNJP Durrës mori pjesë në aktivitetin me temë “Mite dhe fakte mbi seksualitetin e personave me aftësi të kufizuara”.
14.11.2025	QSHNJP Durrës mori pjesë në aktivitetin me temë “Lista e udhëzuesve për asistencën personale”.
18.11.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Botërore për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve, Abuzimi dhe Dhuna pranë Policisë së Shtetit.
25.11.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Botërore kundër Dhunës me Bazë Gjinore.
03.12.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Botërore për Personat me Aftësi të Kufizuara.
09.12.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore.
10.12.2025	QSHNJP Durrës organizoi aktivitet Street Law në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnje

<u>Data</u>	<u>Aktiviteti</u>
12.02.2025	QSHNJP Lushnjë mori pjesë në një aktivitet në kuadër të Ditës së Internetit të Sigurtë, me fokus aspektin ligjor për mbrojtjen e posaçme të të miturve si kategori e veçantë
20.02.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi aktivitet me temë “Ndihma juridike falas – procedura e përfitimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”
12.03.2025	QSHNJP Lushnjë mori pjesë në aktivitetin me temë “Roli i njësive administrative dhe njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve në zbatim të legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje”, Bashkia Lushnje.

08.04.2025	QSHNJP Lushnjë mori pjesë në konferencën lokale “Me Romët për Romët”, me temë “Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimi i romëve në nivel lokal”.
25.04.2025	QSHNJP Lushnjë mori pjesë në takimin me temë “Dhuna ndaj grave në hapësirën dixhitale – menaxhimi efektiv i rasteve dhe mbrojtja e të dhënave personale”.
13.05.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi aktivitet informues për qytetarët e Lushnjës mbi ndihmën juridike falas, përmbajtjen e saj dhe vendndodhjen e re të qendrës.
27.05.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi aktivitet Street Law me fokus promovimin e ndihmës juridike falas.
02.06.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi aktivitet në kuadër të 1 Qershorit – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.
11.06.2025	QSHNJP Lushnjë mori pjesë në takimin me temë “Shërbimet komunitare në ndihmë të familjeve në nevojë”.
13.06.2025	QSHNJP Lushnjë mori pjesë në takimin me temë “Shërbimet sociale të integruara për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të komuniteteve në nevojë”.
18.06.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi aktivitet në kuadër të 19 Qershorit – Dita Ndërkombëtare e Viktimave të Trafikimit.
23.06.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi aktivitet në kuadër të 23 Qershorit – Dita Ndërkombëtare e Egjiptianëve.
26.06.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi aktivitet në kuadër të 26 Qershorit – Dita Ndërkombëtare Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave si dhe Dita Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara në Mbështetje të Viktimave të Torturës.
17.07.2025	QSHNJP Lushnjë mori pjesë në aktivitetin me temë “Karta Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore”.
17.07.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi takime informuese me fokus promovimin e ndihmës juridike falas në qytetin e Divjakës.
28.07.2025	QSHNJP Lushnjë organizoi aktivitet në kuadër të 30 Korrikut – Dita Botërore Kundër Trafikimit të Personave.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër	
<u>Data</u>	<u>Aktiviteti</u>
19.02.2025	QSHNJP Shkodër mori pjesë në aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të Javës së Ndërgjegjësimit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.
20.02.2025	QSHNJP Shkodër mori pjesë në aktivitet informues për ndihmën juridike falas me fokus mbrojtjen ligjore të grave dhe vajzave.
11.03.2025	QSHNJP Shkodër organizoi trajnim me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit “Luigj Gurakuqi”.

19.03.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takim informues me OJF “Drejtësia Sociale” mbi ndihmën juridike për kategoritë e veçanta.
09.04.2025	QSHNJP Shkodër organizoi takim informues me banorë të komunitetit rom për përfitimin e ndihmës juridike falas dhe mbrojtjen e të drejtave, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të pavarura.
25.04.2025	QSHNJP Shkodër mori pjesë në tryezë diskutimi për aksesin në drejtësi dhe barazinë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara.
15.05.2025	QSHNJP Shkodër organizoi takim informues në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes me fëmijë dhe punonjës të një shtëpie familje.
16.05.2025	QSHNJP Shkodër organizoi takim informues në bashkëpunim me shërbimet sociale për ndihmën juridike falas dhe referimin e rasteve.
02.05.2025	QSHNJP Shkodër organizoi aktivitet “Street Law” për informimin e qytetarëve mbi ndihmën juridike falas.
12.05.2025	QSHNJP Shkodër organizoi aktivitet “Street Law” në bashkëpunim me studentë praktikantë për sensibilizimin e qytetarëve.
30.05.2025	QSHNJP Shkodër organizoi aktivitet “Street Law” në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.
11.06.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takim informues me përfaqësues të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
12.06.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takim informues me përfaqësues të OJF-së “Drejtësi Sociale” në kuadër të projektit pilot për ndihmën juridike pranë gjykatës.
17.06.2025	QSHNJP Shkodër mori pjesë në tryezë teknike ndër-institucionale në kuadër të projektit për barazi, përfshirje sociale dhe mosdiskriminim e individëve pjesëtarë të komunitetit LGBTQ+ në Shqipëri.
25.06.2025	QSHNJP Shkodër organizoi takim informues në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve me përfaqësues të komunitetit egjiptian.
14.07.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takime informuese dhe bashkëpunuese me pushtetin vendor për forcimin e aksesit në drejtësi në bashkinë Fushë-Arrëz.
15.07.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takime informuese dhe bashkëpunuese me pushtetin vendor për forcimin e aksesit në drejtësi në bashkinë Malësi e Madhe.
15.07.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takime informuese dhe bashkëpunuese me pushtetin vendor për forcimin e aksesit në drejtësi në bashkinë Vau i Dejës.
28.07.2025	QSHNJP Shkodër organizoi aktivitet “Street Law” në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Viktimave të Trafikimit.
20.08.2025	QSHNJP Shkodër ofroi shërbim ligjor, këshillim dhe informim për familjet rome dhe egjiptiane të prekura nga projekte zhvillimore në qytetin e Shkodrës.
02.10.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takim informues në kuadër të Ditës Botërore të të Moshuarve për problematikat ligjore të kësaj kategorie.
03.10.2025	QSHNJP Shkodër mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje.

18.11.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takim bashkëpunues me përfaqësues të Shtëpisë së Fëmijës në kuadër të mbrojtjes nga shfrytëzimi, abuzimi dhe dhuna.
26.11.2025	QSHNJP Shkodër mori pjesë në aktivitet sensibilizues në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore.
02.12.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takim informues me përfaqësues të shoqatës së personave para-tetraplegjikë për mbrojtjen ligjore të personave me aftësi të kufizuara.
02.12.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takim bashkëpunues me koordinatoren vendore të dhunës në familje për forcimin e mekanizmave mbrojtës.
02.12.2025	QSHNJP Shkodër mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Shkodër në kuadër të Javës së Aftësisë së Kufizuar.
02.12.2025	QSHNJP Shkodër zhvilloi takim komunitar në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore në bashkëpunim me qendrën komunitare.
04.12.2025	QSHNJP Shkodër mori pjesë në aktivitet sensibilizues në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastrë	
<u>Data</u>	<u>Aktiviteti</u>
03.02.2025	QSHNJP Gjirokastrë ishte pjesë e seminarit mbi Mekanizmin e Referimit të Çështjeve në Ndërmjetësim.
19.02.2025	QSHNJP Gjirokastrë zhvilloi aktivitet në kuadër të "Javës ndërgjegjëse të Publikut për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit" për dhunën në familje.
21.02.2025	QSHNJP Gjirokastrë zhvilloi aktivitet në kuadër të "Javës ndërgjegjëse të Publikut për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit" për viktimat e mitur të miturit në konflikt me ligjin.
25.02.2025	QSHNJP Gjirokastrë mori pjesë në takimin mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Shqipërisë.
26.02.2025	QSHNJP Gjirokastrë zhvilloi një intervistë për median lokale RTGJ.
19.11.2025	QSHNJP Mat mori pjesë në takimin e Grupit Teknik Ndërsektorial (ETN), ku u trajtua rasti i disa fëmijëve nga Njësia Administrative Burrel.

26.11.2025	QSHNJP Mat mori pjesë në workshop me anëtarët e Mekanizmit të Referimit dhe Ekipit Teknik Ndërsektorial, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional për dhunën në familje.
03.12.2025	QSHNJP Mat organizoi aktivitet me rastin e 3 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.
04.12.2025	QSHNJP Mat mori pjesë në trajnimin e organizuar nga shoqata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” për mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore.
10.12.2025	QSHNJP Mat organizoi aktivitet informues me rastin e 10 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, në një shkollë të qytetit të Burrelit.
10.12.2025	QSHNJP Mat mori pjesë në aktivitetin përmbyllës të “16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës”, të organizuar nga Bashkia Mat.
11.12.2025	QSHNJP Mat mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërsektorial (ETN), ku u trajtuan raste të dhunës në marrëdhëniet familjare në disa njësi administrative të Bashkisë Mat.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Përmet	
<u>Data</u>	<u>Aktiviteti</u>
19.02.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitete ndërgjegjëse në kuadër të Javës Ndërgjegjëse të Publikut për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.
21.02.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet sensibilizues në kuadër të Javës Ndërgjegjëse të Publikut për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.
24.02.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet informues mbi të drejtat e të rinjve dhe luftën kundër bullizmit dhe gjuhës së urrejtjes.
20.03.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit dhe ndërgjegjësimin për të drejtat e personave që i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shëndetit mendor.
20.03.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet informues në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për të Vërtetën lidhur me Shkeljet e Rënda të të Drejtave të Njeriut dhe për Dinjitetin e Viktimave.
21.03.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet ndërgjegjëses në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down dhe Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit.
28.03.2025	QSHNJP Përmet mori pjesë në intervistë informuese mbi rastet e trajtuara, shërbimet e ofruara dhe kategoritë përfituese, me fokus kategoritë e veçanta të ligjit.
02.04.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet ndërgjegjëses në kuadër të Ditës Botërore të Autizmit.
02.04.2025	QSHNJP Përmet u pasqyrua në kronikë mediatike nga RTGJ mbi shërbimin e Ndihmës Juridike Përmet, rastet e trajtuara dhe kategoritë përfituese.
08.04.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve.

29.04.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet informues për njohjen e qytetarëve me procesin e ndërmjetësimit.
09.05.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.
09.05.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet informues në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.
14.05.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes.
20.05.2025	QSHNJP Përmet zhvilloi aktivitete ndërgjegjësuere dhe edukative mbi të drejtat ligjore dhe aksesin në ndihmën juridike falas.
11.06.2025	QSHNJP Përmet bashkëpunoi në zhvillimin e aktiviteteve në bashkitë e vogla, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt.
11.06.2025	QSHNJP Përmet bashkëpunoi në zhvillimin e aktivitetit “Street Law” pranë Bashkisë Tepelenë.
11.06.2025	QSHNJP Përmet bashkëpunoi në zhvillimin e aktivitetit “Street Law” në Memaliaj, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave.
23.06.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve.
07.07.2025	QSHNJP Përmet mori pjesë në intervistë informuese mbi rastet e trajtuara në 6-mujorin e parë të vitit 2025 dhe rolin e ndërmjetësimit si alternativë që kursen kohë dhe kosto.
11.07.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet informues mbi të drejtat ligjore dhe shërbimet që qytetarët mund të përfitojnë në rast nevojë.
23.07.2025	QSHNJP Përmet zhvilloi diskutime mbi çështjet prioritare për komunitetin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet strukturave vendore dhe qytetarëve.
23.07.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet informues mbi barazinë gjinore, përfshirjen dhe bashkëpunimin për një shoqëri më të drejtë.
28.07.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave.
19.08.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet përkujtimor në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Akteve të Dhunës bazuar në Fe ose Besim.
19.08.2025	QSHNJP Përmet zhvilloi aktivitete informuese mbi Ndihmën Juridike Falas për personat në nevojë.
03.09.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të 5 Shtatorit – Ditës Ndërkombëtare të Bamirësisë.
11.09.2025	QSHNJP Përmet zhvilloi aktivitete informuese mbi aksesin e qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit.

22.09.2025	QSHNJP Përmet kontribuoi në forcimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje.
03.10.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Pa Dhunë dhe promovimit të ndërmjetësimit si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve.
10.10.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet sensibilizues në kuadër të 11 Tetorit – Ditës Ndërkombëtare të Vajzave të Mitura.
12.10.2025	QSHNJP Përmet zhvilloi aktivitete mbi bashkëpunimin ndërinstitutional dhe rëndësinë e referimit të rasteve që mund të zgjidhen përmes dialogut dhe marrëveshjes.
13.10.2025	QSHNJP Përmet mori pjesë në intervistë informuese për periudhën Korrik–Shtator, mbi rastet e trajtuara.
22.10.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet informues mbi të miturit në konflikt me ligjin si kategori përfituese e ndihmës juridike falas.
18.11.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet në kuadër të 18 Nëntorit – Ditës për Parandalimin dhe Shërimin nga Shfrytëzimi Seksual, Abuzimi dhe Dhuna ndaj Fëmijëve.
03.12.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet sensibilizues në kuadër të javës së dytë të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës në Familje” dhe Ditës Botërore kundër AIDS.
03.12.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitete në kuadër të Ditës Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe “16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës në Familje”.
11.12.2025	QSHNJP Përmet organizoi aktivitet informues në kuadër të Ditës Botërore të të Drejtave të Njeriut.

5.2 ZHVILLIMI I INTERVISTAVE TELEVIZIVE NË KUADËR TË EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT

Përgjatë vitit 2025, nga ana e DNJF janë zhvilluar në total 31 intervista/ dalje mediatike, në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike, edukimit ligjor të publikut të listuara si më poshtë vijon:

- **Janë zhvilluar 7 intervista** nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas:

1. **Shkurt 2025** – Intervistë e Drejtorit të Përgjithshëm z. Ergys Qirici për Televizionin MCN.

Linku: <https://youtu.be/p4Ucnkq0ypk?si=m7bBshfrF2I6EgZv>

2. **Shkurt 2025** – Intervistë e Drejtorit të Përgjithshëm, të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z. Ergys Qirici, dhënë për Radio Televizioni Shqiptar.

Linku: <https://youtu.be/7qQlwPQZQog?si=kj75ntMLTGNkRbAX>

3. **Maj 2025** - Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore znj. Patricia Pogaçe dhe specialistë pranë DNJF ishin pjesë e kronikës së emisionit "Pyet Avokatin", në Radio Televizionin Shqiptar.
Linku: <https://youtu.be/E-hnsWlJ8J8?si=41ndvDaKQm5FgSPe>
4. **Qershor 2025** - Intervistë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standarteve dhe Administrimit të Ndhmës Parësore, znj. Klejda Poçi, për RTSH Kukësi.
Linku: <https://www.facebook.com/share/v/1Gt3RDa53N/?mibextid=wwXlfr>
5. **Korrik 2025** - Intervistë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore, znj. Patricia Pogaçe, për TV "Ora News".
6. **Tetor 2025** - Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, ishte e ftuar në podcastin "Proligj" për të folur mbi ndihmën juridike falas.
Linku: <https://youtu.be/UAoVCBRKZk8?si=5X-rMfoVEBTLKsTV>
7. **Dhjetor 2025** – Përfaqësues të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, znj. Helga Çela dhe znj. Sindi Prifti, morën pjesë në episodin e podcastit "Podflas".
Linku: <https://youtu.be/MiS09ptrY3U?si=p5OR0q6EBT7Sxoro>
- **Janë zhvilluar 24 intervista televizive/radio** nga QSHNJP, në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike, edukimit ligjor të publikut të listuara si më poshtë vijon:
 1. 18.02.2025 – Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Korçë.
Link: https://www.youtube.com/watch?v=3wg_OLSMOoQ&pp=ygUbbmRpaG1hIGp1cmlkaWtIGZhbGFzIGtvcmlNI
 2. 20.02.2025- Dalje televizive e realizuar nga QSHNJP Vlorë.
Link: <https://www.facebook.com/share/v/1E5TUVrakh/>
 3. 26.02.2025- Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë.
Link: https://youtu.be/aL_cQ-kEZkE?si=PBZrtFKtatxJzpNk
 4. 21.03.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë.
Link: <https://youtu.be/LanHod8YQi4?si=mGqzNAmX9z2LaPkk>
 5. 28.03.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Përmet.
Link: https://youtu.be/OkC1bPx-Ai0?si=wpf2fgmpm_iLdnEm
 6. 02.04.2025 – Realizuar kronikë televizive nga punonjësja e QSHNJP Përmet për gazetarin e RTGJ.
Link: <https://www.facebook.com/share/v/18cPiEhgUo/?mibextid=wwXlfr>

7. 10.04.2025- Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë me median Euronews.
Link: <https://euronews.al/rriten-kerkesat-per-ndihme-jurdike-falas-362-raste-ne-2024-en/>.
8. 10.04.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë me median 6 plus1, Vlorë.
Link: <https://youtu.be/VDL7dcDTCOI?si=2BbZMNSuIt9ITxRD3>
9. 22.04.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë për median Top Channel.
Link: <https://youtu.be/TPef7cGbgIQ?si=bnk1b9SPpDcna0jW>
10. 22.04.2025- Realizuar intervista nga punonjësi i QSHNJP Mat.
Link: <https://mattv.al/qendra-e-sherbimit-ligjor-falas-ne-burrel-e-hapur-per-te-pritur-te-gjitha-grupet-qe-perfshin/>
11. 29.04.2025 - Realizuar intervista radiofonike nga punonjësja e QSHNJP Korçë, për Radion Emanuel.
Link: https://youtu.be/6djdCyFok_ë?si=3SgBQTx7mIVofgsn
12. 07.07.2025 - Realizuar intervista t nga punonjësja e QSHNJP Përmet, në RTSH Gjirokastrë.
Link: <https://youtu.be/9zz49LOWPeA>
13. 08.07.2025 – Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë, me median lokale RTGJ.
Link: https://youtu.be/7qeRS2-mmEs?si=OnT02S5nx_Rcmu08
14. 15.07.2025 – Realizuar intervista televizive nga punonjësi i QSHNJP Elbasan, për median RTSH.
Linku: <https://youtu.be/6jv28QzZbYU?si=JDw0YPVAzssSvyXD>
15. 15.07.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësi i QSHNJP Shkodër, për TV Koplikun.
Link: <https://www.facebook.com/share/v/1FbrZMC7zz/>
16. 24.07.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Korçë me median RTSH Korçë.
Link: <https://youtu.be/Sw1gpN-tq5k?si=rbJSHFNHcLCU0KZR>
17. 10.09.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjëset e QSHNJP Fier, për RTSH 24.

18. 29.09.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësi i QSHNJP Kukës.
Link: <https://m.youtube.com/watch?si=3Onhkw2zesF2QueA&v=L8XmV9jwbLI&feature=youtu.be>
<https://www.facebook.com/share/v/17Nebw62mW/?mibextid=wwXIfKavaj>
19. 29.09.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Tropojë.
Link: <https://m.youtube.com/watch?si=3Onhkw2zesF2QueA&v=L8XmV9jwbLI&feature=youtu.be>
<https://www.facebook.com/share/v/17Nebw62mW/?mibextid=wwXIfKavaj>
20. 13.10.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Përmet, për median RTSH Gjirokastrë.
Link: <https://youtu.be/TJ3dqfzAfUQ?si=Jk2mJQcNmVlfoE8M>
21. 14.10.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë, në RTSH Gjirokastra.
Link: <https://youtu.be/hu-kCBW6PrQ?si=NAYzHcvod0MMyj7X>
22. 14.10.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Korçë, në RTSH Korça.
Link: <https://www.youtube.com/watch?v=RE4543qZmqQ&pp=ygUKcnRzaCBrb3JjYQ%3D%3D>
23. 16.10.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë, me median Euronews.
Link: <https://youtu.be/2WcveMd18x0?si=S0AtNLGe5o8Y1Ntc>
24. 20.10.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësi i QSHNJP Elbasan.
Link: https://youtu.be/Q9hge-or_0w?si=PPc7TK7AWcmxSKYG
25. 20.11.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Durrës.
Link: https://shqiptarja.com/lajm/350-raste-ne-vit-qendra-e-ndihmes-juridike-durres-ofron-mbrojtje-ligjore-falas-grate-viktima-te-dhunes-perfitueset-kryesore?fbclid=Iëb21jcAOLzXZleHRuA2FlbQIxMABzcnRjBmFëcF9pZAo2NjI4NTY4Mzc5AAEeTI8PcBIYR9ëxYUTbLPqkSBTëTins7qn-hM4dv7kV3t2u8u7TNRZ8D8_8lmo_aem_QeY9G8Jq8hjtPDiZ2hK77Q
26. 12.12.2025 - Realizuar intervista televizive nga punonjësja e QSHNJP Gjirokastrë.
Link: <https://youtu.be/aLmmssgaVIQ?si=MQTjGpajOPsStQ5o>
27. 29.12.2025 – Realizuar kronikë televizive mbi intervistën e QSHNJP Vlorë nga televizioni 6 plus 1.
Linku: <https://youtu.be/8PI-pp6G6Hk?si=uf6K-Loh9e6A9DJW>

5.3 NËNSHKRIMI I MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR SI DHE ME ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE QË OPEROJNË NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË QYTETARËVE.

Përgjatë vitit 2025, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucionet e tjera që kanë në fokus të tyre mbrojtjen e të drejtave ligjore të qytetarëve është bërë e mundur **nënshkrimi i 12 (dymbëdhjetë) marrëveshjeve të bashkëpunimit** “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” dhe konkretisht:

1. Marrëveshje mirëkuptimi nr. 279 prot, datë 23.01.2025 me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk dëgjojnë (ANAD).
2. Marrëveshje mirëkuptimi nr. 656/1 prot, datë 03.03.2025 me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
3. Marrëveshje mirëkuptimi nr. 1009 prot, datë 08.04.2025 me organizatën “Aleanca Gjimore për Zhvillim”;
4. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1555 prot, datë 18.06.2025 me bashkinë Kamëz;
5. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1588 prot, datë 23.06.2025 me bashkinë Peqin;
6. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1587 prot, datë 23.06.2025 me bashkinë Rrogozhinë;
7. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1729 prot, datë 15.07.2025 me bashkinë Malësi e Madhe;
8. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1730 prot, datë 15.07.2025 me bashkinë Vau Dejës;
9. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1987 prot, datë 10.09.2025 me bashkinë Finiq;
10. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1986 prot, datë 10.09.2025 me bashkinë Delvinë;
11. Memorandum bashkëpunimi nr. 1995 prot, datë 11.09.2025 me organizatën “Drejtësi Sociale”;
12. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 3576/1 prot, datë 12.12.2025 me bashkinë Tepelenë.

Qëllimi i këtyre marrëveshjeve konsiston kryesisht në bashkëpunimin e palëve sa i përket:

- ✓ Promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese, edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- ✓ Shkëmbimin e përvojës në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- ✓ Zhvillimin e takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- ✓ Planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- ✓ Kryerjen e analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion

të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.

- ✓ Referimi i rasteve për të përfituar ndihmë juridike parësore falas.

6 TRAJNIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka administruar nevojat për trajnime të vazhdueshme, të përcjella nga punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore dhe është mundësuar përfshirja e tyre në programin e planifikimit të trajnimeve vazhduese.

Pas administrimit të nevojave për zhvillimin e trajnimeve vazhduese të përcjella nga punonjësit e qendrave, DNJF i është drejtuar DAP/ASPA me shkresën me nr. 186 prot, datë 16.01.2025 me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim për miratimin e programit të planifikimit të trajnimeve vazhduese për vitin 2025, si dhe zhvillimin e trajnimeve, si detyrim ligjor, i përcaktuar në nenin 9, shkronja “g” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Nga ana e ASPA-s është zhvilluar **trajnimi vazhdues për periudhën 20 – 27 Gusht 2025**. Temat e zhvilluara përgjatë këtij trajnimi ishin:

1. Ndhma Juridike Falas në kontekstin e Bashkimit Evropian.
2. Ndhma Juridike Falas dhe Ndërmjetësimi.
3. Strategjitë e komunikimit në drejtim të promovimit të shërbimit ligjor falas.
4. Ndërveprimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me avokatët ofrues të ndihmës juridike dytësore.
5. Nocioni i paraligjorit, kuadri ligjor dhe funksionimi i tij në dobi të komunitetit.
6. Analizë e funksionimit 5 vjeçar të skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

DNJF i është drejtuar për mbështetje edhe organizatave ndërkombëtare me shkresën me nr. 189 prot., datë 16.01.2025 me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim drejtuar organizatave ndërkombëtare mbështetëse UNDP, ADA, CLE, për rritjen e kapaciteteve dhe aftësimit profesional të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Gjithashtu DNJF i është drejtuar me një kërkesë për bashkëpunim edhe organizatës “ANTRAC” me shkresën nr. 667 prot, të datës 27.02.2025, lidhur me zhvillimin e aftësive profesionale të ofruesve të ndihmës juridike parësore.

Bazuar edhe te kërkesat e mësipërme për bashkëpunim, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në bashkëpunim edhe me organizatat jofitimprurëse ka zhvilluar trajnimet e mëposhtme:

- 10.09.2025 - Trajnimi me fokus tek pakicat rome dhe egjiptiane, në bashkëpunim me organizatën “Drejtësi Sociale”.
- 30.09.2025 - Trajnimi me temë “Forcimi i njohurive ligjore, të drejtave të punës dhe aftësive të informimit për punonjësit e Qendrave të Ndhmës Juridike Falas” në bashkëpunim me qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”.

- 10.11.2025 - Trajnimi online për Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore me temë: *“Rritja e kapaciteteve të ofruesve të ndihmës juridike parësore për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”* në bashkëpunim me Qendrën *“Të drejtat e njeriut në demokraci”*.
- 05.12.2025 – Trajnimi mbi procedurat e azilit dhe statusit të refugjatit në bashkëpunim me Prezencën e UNHCR në Shqipëri.

7 KONTRIBUTE DHE RAPORTIME TË DNJF-SË NË KUADËR TË PROCESVE STRATEGJIKE

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme sa i përket:

Nr.	Emërtimi i Strategjisë
1	Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë për të Mitur 2024-2030, Planit të saj të Veprimit, si dhe Pasaportës së Indikatoreve
2	Strategjia Ndërsektorale Për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030
3	Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë dhe Planit të saj të Veprimit 2024-2030
4	Pyetësi CEPEJ Dashboard Western Balkans
5	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030
6	Plani i Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027
7	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
8	Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO)
9	Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR)
10	SASPAC – Raportimi i strukturave përgjegjëse për programimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve me financim të huaj në institucionet e administratës shtetërore
11	Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2021–2022”
12	Raport Monitorimi Zbatimi i Planit të Integritetit në kuadër të GRECO-s
13	Konventa Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), Neni 13.
14	“Grupi Ndërinstitucional i Punës dhe Task Forcës” referuar marrëveshjes së bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave.
15	GRETA-s, Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.
16	CESCR, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

17	IPA 2025-2027
18	Raporti i Rezultateve të IRM për Planin e Veprimit OGP të Shqipërisë
19	Rezoluta 1235
20	Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030
21	Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025

8 RAPORTIME NDËRKOMBËTARE

Në kuadër të procesit të Integritimit Evropian, DNJF ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme sa i përket:

Nr.	Dokumenti
1	Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kriterit Politik.
2	Procesi i Hartimit të udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të planifikimit të masave për hartimin e Paketës Semestrale për Integrimin Evropian (PSIE) 2024. - Kontribut i DNJF-së, në kuadër të hartimit të Progres Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë. - Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2025 -2027.
3	Kontribut i DNJF-së, në kuadër të raportit paraprak mbi vizitën faktmbledhëse të bashkëraportoreve të Asamblesë Parlamentare të KiE për Shqipërinë.
4	Kontribut i DNJF-së, në kuadër të takimit të 17-të i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit Bashkimi Evropian – Shqipëri.
5	Rule of Law report Rule of Law Report 2024- Në publikimin e Raportit Vjetor mbi Sundimin e Ligjit 2024, Komisioni Evropian, përfshin për herë të parë Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Në paragrafin kushtuar “ <i>Qasja në Drejtësi dhe roli i avokatëve në sistemin e drejtësisë</i> ”, mbyllet me fjalinë: “ <i>Përtej BE-së, Shqipëria ka një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për ndihmën juridike dhe numri i përfituesve të saj është rritur</i> ”.
6	Raporti i Vlerësimit të Kapaciteteve të Integritimit Evropian (CAF)

9 BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE MBËSHTETËSE.

Bashkëpunimi me UNDP’

Gjatë vitit 2025, bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) u fokusua në përmbylljen e projektit **EFLAS**,

i cili përfundoi në **shkurt 2025**. Në kuadër të këtij projekti, UNDP ofroi asistencë teknike dhe institucionale për konsolidimin e sistemit të ndihmës juridike falas, forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimit dhe përmirësimin e mekanizmave të aksesit në drejtësi. Përfundimi i projektit EFLAS krijoi një bazë të qëndrueshme për vijimin e partneritetit strategjik ndërmjet palëve, duke hapur rrugën për përgatitjen e bashkëpunimit të ri në kuadër të projektit **EQUALS**, i planifikuar për fazën pasuese.

Bashkëpunimi me OSBE-në

Gjatë vitit 2025, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka asistuar DNJF-në përmes realizimit të një **analize të posaçme mbi nevojën për ndryshime ligjore** në fushën e ndihmës juridike falas, e cila shërbeu si bazë për identifikimin e problematikave dhe boshllëqeve në kuadrin ekzistues ligjor. Paralelisht, me mbështetjen e OSBE-së u zhvilluan **aktivitete ndërgjegjëse dhe informuese në zona të largëta gjeografikisht**, ku nuk funksionojnë qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Këto aktivitete u realizuan në bashkëpunim me institucionet vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin lokal, duke kontribuar në rritjen e aksesit në informacion dhe shërbime ligjore për qytetarët në këto zona.

Bashkëpunimi me CSSP

Në kuadër të bashkëpunimit me **CSSP – Berlin Center for Integrative Mediation**, gjatë vitit 2025 u mundësua ofrimi i **shërbimit të ndërmjetësimit falas** për qytetarët, si një mekanizëm alternativ dhe efikas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, në bashkëpunim me CSSP u organizuan **tryeza informuese dhe aktivitete ndërgjegjëse mbi ndërmjetësimin**, me qëllim rritjen e njohurive të publikut dhe institucioneve mbi këtë instrument dhe forcimin e mekanizmave të referimit të rasteve nga ndihma juridike drejt ndërmjetësimit.

Bashkëpunimi me UNHCR

Gjatë vitit 2025, në bashkëpunim me **UNHCR**, DNJF u angazhua në realizimin e një **analize të posaçme mbi nevojat për ndryshime ligjore**, me fokus të veçantë te **migrantët dhe azilkërkuesit**. Kjo analizë synoi identifikimin e barrierave ligjore dhe procedurale në aksesin e këtyre kategorive në ndihmën juridike falas, si dhe formulimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe praktikës institucionale, në përputhje me standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

10 PROKURIMET

DNJF, në strukturën e saj, nuk ka një sektor të posaçëm i cili meret me prokurimin e fondeve. Në mungesë të saj, bazuar në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 5, datë

25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, të ndryshuar, titullari i DNJF-së, çdo vit ngre një komision për prokurimet i cili ushtron kompetencat e tij gjatë gjithë vitit kalendarik.

Bazuar në nenin 3 të Vendimit Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Udhëzimit Nr.04, datë 18.06.2021 “Për hartimin e Regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe Regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, gjatë vitit 2025 DNJF për nevojat e saj ka hartuar regjistrin e parashikimeve për prokurimin e fondeve në dispozicion, një kopje të të cilit e ka dërguar në degën e thesarit Tiranë dhe një kopje në MD.

Në zbatim të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 56 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, të ndryshuar, Urdhri i Brendshëm nr. 6 prot., datë 07.01.2025, të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël”, Urdhri i Brendshëm nr. 7 prot., datë 07.01.2025, të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas “Për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve”, i ndryshuar referuar kërkesave për prokurim, ka realizuar procedurat e prokurimit si vijon:

1. Blerje bojë për printer dhe fotokopje;
2. Blerje karburanti;
3. Blerje materiale kancelarie dhe letër printimi;
4. Blerje materiale pastrimi;
5. Blerje pajisje elektronike;
6. Pjesë këmbimi për automjete;
7. Riparime dhe mirembajtje automjeti;
8. Shërbime informatike, konsulence, zhvillim programesh, internetit dhe suportit;
9. Siguracion i detyrueshëm për automjete;
10. Rimbushje, kolaudim dhe certifikim zjarri;
11. Shërbim dezinfektim, dezinfektim, deratizim;
12. Libra të shtypur, broshura dhe fletëpalosje;
13. Materiale Ekeltrike dhe hidraulike.

Në kuadër të realizimit të procedurave të sipërcituara u përgatit dokumentacioni i nevojshëm, u shpallën procedurat në faqen elektronike të APP-së www.app.gov.al, u realizua hapja dhe

vlerësimi i ofertave pjesëmarrëse, u konfirmua operatori fitues si dhe u hartua raporti përmbledhës për secilën prej procedurave.

Referuar Regjistrimit të Parashikimeve nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) janë realizuar 13 (trembëdhjetë) zëra sipas kërkesave të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit dhe nuk janë realizuar 3 (tre) zëra: “Blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar”, “Blerje paisje dhe mobilje zyre” dhe “Artikuj të ndryshëm” për arsye si mëposhtë:

- Për zërin “Blerje pajisje, orendi zyre” DNJF ka marrë në përdorim nga donatori UNDP, mjete pune për punonjësit e qendrave të Ofrimit të Ndhmës Juridike Falas të cilat më herët kanë qënë financuar nga kjo organizatë. Për këtë arsye, gjatë vitit 2025 nuk lindi nevoja e prokurimit të këtij zëri.

- Për zërin “Blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar”, institucioni ynë nuk ka patur raste të udhëtimit jashtë vendit.

- Gjithashtu edhe për zërin “Artikuj të ndryshëm”, nuk lindi nevoja e prokurimit të këtij zëri.

Theksojmë se janë përmbushur të gjitha nevojat e institucionit duke përdorur fondet me efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet (në total 81%).

11 TË DHËNA BUXHETORE

Detajimi i buxhetit për vitin 2025 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe është realizuar duke mbajtur parasysh objektivat, qëllimin e synuar, përfituesit.

DNJF, për vitin 2025, ka patur si qëllim të saj ofrimin e ndihmës juridike falas për individët që plotësojnë kushtet, si edhe zbatimin dhe monitorimin e cilësisë së dhënies së ndihmës juridike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për realizimin e këtij qëllimi janë përcaktuar objektivat e mëposhtme:

1. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike.
2. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për gratë dhe vajzat, pjesë e kategorisë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike.

Tabela e mëposhtme paraqet fondet e akorduara nga buxheti i shtetit dhe donatorëve dhe realizimin e tyre në vlerë dhe përqindje.

Art.	Emërtimi	Plani i vitit 2024	Realizimi viti 2024 (në 000 lekë)	Realizimi në
------	----------	--------------------	--------------------------------------	--------------

		(në 000 lekë)		përqindje i buxhetit
600	Paga	57 500	48 136	84%
601	Sigurime Shoqërore	9 600	8 022	84%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	29 526	27 585	93%
604	Transf korrente të brendshme për OJF-të	4 800	3 419	71%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	124	6	4,8%
231	Kapitale te trupezuara	500	411	82%
	Shpenzime Korrente	102 050	87 579	86%
	Të ardhura nga grantet për paga	2 342	2 269	97%
	Të ardhura nga grantet për mallra dhe shërbime të tjera	370	359	97%
	Shpenzime nga të ardhura jashtë limiti	2 712	2 628	97%
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardhura jashtë limiti)	104 762	90 207	86%

1. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore:

Fondet e çelura nga buxheti i shtetit në vlerën totale 67.100.000 lekë (57.5.000 lekë paga dhe 9.600.000 lekë sigurime shoqërore) nga të cilat realizuar 56.157.607 lekë ose e shprehur në përqindje në masën 84%. Realizimi i këtij buxheti i përket fondit të pagave dhe sigurimeve për 38 punonjës nga 49 të miratuar në strukturën organizative të organizimit dhe funksionimit të DNJF.

2. Fondi i shpenzimeve për vendimet gjyqësore:

Gjatë vitit 2025 në total janë shlyer detyrimet financiare me objekt “*ndihmën juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet*” për 593 vendime gjyqësore, me një kosto prej 20.811.129 lekë.

3. Fondi për shpenzimet për funksionimin e veprimtarisë së institucionit është realizuar në vlerën 6.783.741 lekë. Gjithsej fondi për llogarinë ekonomike 602 (shpenzime operative) është realizuar në masën 93%.

4. Shpenzimet kapitale

Për vitin 2025 Drejtoria e Ndihmës Juridike ka patur buxhet të çelur për investime në vlerën 500.000 lekë, prej të cilave janë realizuar 411.480 lekë (82%).

Pjesë e buxhetit të vitit 2025 janë edhe fondet e akorduara nga organizata ndërkombëtare UNDP për mbulimin e shërbimit juridik parësor për kategoritë përfituese, sipas ligjit për ndihmën juridike në Qendrat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë (*gjithsej 6 Qendra me financim nga UNDP*). Fondet e akorduara gjatë këtij viti janë në vlerën 2.711.395 lekë, me fokus pagesën e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 6 Qendra të Shërbimit të Ofrimit të Ndhmës Juridike Parësore për muajt Janar dhe Shkurt, që përkojnë me përfundimin e marrëveshjes së bashkëpunimit. Në muajin Maj 2025, këto qendra të financuara nga donator UNDP, kaluan pjesë e strukturës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe tashmë financohen me fonde të buxhetit të shtetit.

Ky fond është realizuar në masën 97% në vitin 2025.

12 ARRITJET E DNJF PËR VITIN 2025- VËSHTRIM KRAHASIMOR 2021 - 2025

Gjatë vitit 2025, DNJF ka shënuar progres të dukshëm si në aspektin institucional, ashtu edhe në ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve për qytetarët. Miratimi i strukturës së re organizative, rritja e kapaciteteve njerëzore, zgjerimi i rrjetit të ofruesve të shërbimit dhe forcimi i bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse, universitetet dhe partnerët ndërkombëtarë kanë kontribuar në rritjen e mbulimit territorial dhe cilësisë së shërbimit.

Në aspektin e shërbimeve, DNJF ka asistuar mbi **5,400 qytetarë me ndihmë juridike parësore** dhe **841 qytetarë me ndihmë juridike dytësore**.

Paralelisht, është shënuar një rritje prej **48% e vendimeve gjyqësore të likuiduara**, si dhe një rritje prej **41.5% e buxhetit të shpenzuar për këtë qëllim**, çka dëshmon për funksionalitet më të lartë të sistemit dhe rritje të kërkesës për shërbimin.

DNJF ka investuar ndjeshëm në forcimin e kapaciteteve profesionale, përmes trajnimeve të detyrueshme dhe bashkëpunimeve tematike me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si UNDP, OSBE, UNHCR dhe organizata të shoqërisë civile, duke adresuar në mënyrë të posaçme nevojat e grupeve vulnerabël, përfshirë gratë, vajzat, viktimat e dhunës me bazë gjinore, komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe azilkërkuesit.

Në mënyrë të detajuar arritjet kryesore parashtrohen si vijon:

1. **Miratimi i strukturës së re organizative** nga Kryeministri, duke mundësuar shtimin e numrit të punonjësve të Drejtorisë dhe sigurimin e financimit për 6 qendrat e ndihmës juridike parësore të ngritura në bashkëpunim me UNDP dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim.
2. **Përfundimi me sukses i procesit të autorizimit të përhershëm** për 14 organizata jofitimprurëse që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore, përmes lëshimit të urdhrave nga Ministri i Drejtësisë.
3. **Financimi nga buxheti i institucionit** për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për 4 organizata jofitimprurëse të shpallura fituese.
4. **Nënshkrimi i kontratave të shërbimit** me 140 avokatë nga lista e ofruesve të ndihmës juridike dytësore për vitin 2025.
5. **Monitorimi fillestar i 50 avokatëve** në 13 Dhomat Vendore të Avokatisë, të cilët kanë kontrata aktive për herë të parë me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

6. **Trajnimi i 293 studentëve** të Klinikave të së Drejtës në 12 universitete, mbi ligjin nr. 111/2017 dhe aktet nënligjore përkatëse.
7. **Përfundimi i praktikave 3-mujore** për 94 studentë të Klinikave të Ligjit në 12 universitete, në kuadër të zbatimit të ligjit për ndihmën juridike falas.
8. **Vlerësimi periodik i performancës** së punonjësve të qendrave, bazuar në indikatorët e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
9. **Zhvillimi i trajnimit të detyrueshëm me ASPA** për punonjësit e të gjitha qendrave, gjatë datave 20–27 gusht 2025, me temë: *“Zhvillimi i sistemit të ndihmës juridike falas në Shqipëri në perspektivën e standardeve të Bashkimit Evropian”*.
10. **Afishimi i numrit të gjelbër 08001010** në faqet zyrtare të 15 gjykatave të vendit dhe në faqen zyrtare të KLGJ-së.
11. **Organizimi/pjesëmarrja në 543 aktivitete ndërgjegjësuere** nga Drejtoria dhe qendrat e shërbimit, në zbatim të kalendarit vjetor.
12. **Realizimi i 26 daljesh mediatike dhe intervistave** për promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas.
13. **Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat vendore** për zhvillimin e Trajnimeve tematike për ofruesit e shërbimit. Nga janari në nëntor 2025 u zhvilluan 4 module trajnimi me organizatat: “Aleanca Gjimore për Zhvillim” – të drejtat e punës dhe komunikimi efektiv, “Drejtesi Sociale” – regjistrimi civil i romëve dhe egjiptianëve, “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” – mbështetje për viktimat e dhunës me bazë gjimore dhe dhunës në familje, UNHCR – legjislacioni për refugjatët dhe azilkërkuesit.
14. **Nënshkrimi i 13 marrëveshjeve të reja bashkëpunimi** me institucione qendrore dhe vendore, universitete dhe organizata partnere, për zgjerimin e informacionit dhe referimit të rasteve.
15. **Pjesëmarrja me 35 kontribute institucionale** në procesin e integritetit evropian dhe në hartimin/raportimin e strategjive sektoriale.

Tregues kyç performance.

1. **Shërbimet e ofruara për qytetarët:**
 - **5,416 qytetarë të asistuar me ndihmë juridike parësore;**
 - **841 qytetarë përfitues të ndihmës juridike dytësore.**
2. **Likuidimi financiar:**
 - 521 avokatë dhe ekspertë të paguar për shërbimet e kryera, me një vlerë totale prej 18,377,729 lekësh (Janar–Nëntor 2025).
 - Krahastuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024:
 - **48% rritje** në numrin e vendimeve gjyqësore të likuiduara krahasimisht me 2024.
 - **41.5% rritje** në buxhetin e shpenzuar për likuidimin e tyre krahasimisht me 2024.

• Përmirësimet kryesore 2025 krahasimisht me 2024

1. Zgjerim dhe konsolidim institucional

- Nga **14 qendra** të ndihmës juridike parësore (2024) në **20 qendra të financuara plotësisht nga buxheti i shtetit** (2025).

- **RISI thelbësore:** 6 qendrat e hapura me mbështetje UNDP janë integruar plotësisht në strukturën e DNJF, duke garantuar **qëndrueshmëri afatgjatë të shërbimit** (rast suksesi rajonal).

2. Rritje e cilësisë në ndihmën juridike dytësore

- Vendoset fokus i qartë tek **cilësia e shërbimit**, përmes kontratave tip dhe monitorimit të detyrueshëm.
- Përmirësim i performancës:
 - 2024: 94% praktika të vlerësuara për pagesë
 - 2025: **95% praktika të vlerësuara për pagesë**

3. Rritje e ndjeshme e likuidimeve financiare

- **+48% rritje** e numrit të vendimeve gjyqësore të likuiduara (521 në 2025 nga 391 në 2024).
- **+41.5% rritje** e buxhetit të shpenzuar për likuidime (18.3 mln lekë në 2025 nga 14.2 mln lekë në 2024). Tregon funksionalitet më të lartë dhe rritje të besimit në sistem.

4. Forcim i kapaciteteve njerëzore dhe akademike

- Studentë të trajnuar në Klinikat e Ligjit:
 - 2024: 91 studentë
 - 2025: **273 studentë (+33% rritje)**
- Ruhet niveli i praktikave profesionale (94 studentë në 2025).

5. Mbështetje më e strukturuar për OJF-të

- Miratohen ndryshime në VKM nr. 55/2019:
 - Lehtësohet procedura e autorizimit;
 - Garantohej **autorizim pa afat** për OJF-të.
- Për herë të dytë realizohet **mbështetje financiare direkte** për 4 OJF të autorizuar, duke rritur qëndrueshmërinë e shërbimit.

6. Rritje e ndjeshme e buxhetit dhe efijencës financiare

- Realizimi buxhetor:
 - 2024: 35.3 mln lekë
 - 2025: **79.7 mln lekë** (më shumë se dyfishim)
- Rritje e fondeve buxhetore të alokuara dhe menaxhim më efikas i shpenzimeve.

7. Angazhim i lartë ndërinstitucional dhe ndërgjegjësues

- 35 kontribute institucionale në procesin e integritetit evropian.
- 543 aktivitete ndërgjegjëse dhe 26 dalje mediatike.
- Afishimi i numrit të gjelbër 08001010 në 15 gjykata dhe në faqen e KLGJ-së.
- **Vështrim tabelar i ecurisë së institucionit në vitin 2024 dhe 2025 parashtrohet si vijon:**

Nr.	Arrijtjet për çdo objektiv	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
1	Numri i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore	33 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore (10 Qendra, 12 OJF; 11 Klinika Ligji pranë Universiteteve)	41 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore (14 Qendra, 15 OJF; 12 Klinika Ligji pranë Universiteteve)	47 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore (20 Qendra, 15 OJF; 12 Klinika Ligji pranë Universiteteve)	47 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore (20 Qendra, 14 OJF; 13 Klinika Ligji pranë Universiteteve)	47 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore (20 Qendra, 14 OJF; 13 Klinika Ligji pranë Universiteteve)
2	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga qendrat të shërbimit të ndihmës juridike parësore	10 QSHNJP (Tiranë, Durrës, Lushnje, Fier, Vlorë, Pogradec, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër dhe Dibër) 2 Qendra me buxhet shteti në Tiranë dhe Lushnje 8 Qendra me mbështetjen e PNUD (Për vitin 2021 janë hapur 3 qendrat e reja në Vlorë, Dibër dhe Fier).	14 QSHNJP (Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër, Dibër, Kukës dhe Korçë) 4 Qendra me buxhet shteti. Kaluar qendra Shkodër dhe Durrës me buxhet shteti. (Tiranë, Lushnje, Shkodër dhe Durrës) 10 Qendra me mbështetjen e PNUD (Për vitin 2022 janë hapur 4 qendrat e reja në Berat, Elbasan, Korçë dhe Kukës) Në vijim të mbylljes së sporteve të ADISA, më dt. 16.05.2022, Drejtori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me PNUD, zhvilloi një takim me Kryetaren e	20 (njëzetë) QSHNJP si vijon: 8 (tetë) QSHNJP financohen nga UNDP/ADC në qytetin e Lezhës, Pogradecit, Vlorës, Dibrës, Kukësit, Korçës, Beratit dhe Elbasanit, kurse 12 (dymbëdhjetë) qendra si: Tirana, Lushnja, Durrësi, Shkodra, Tropoja, Përmeti, Puka, Mati, Kavaja, Kurbin, Gjirokastra dhe Fieri (financohen nga buxheti i shtetit). Përgjatë vitit 2023 është bërë i mundur kalimi nën administrim si pjesë e strukturës së institucionit të 2 qendrave hapura me mbështetjen e UNDP në Fier dhe Gjirokastrë (në kuadër të marrëveshjes mes	20 (njëzetë) QSHNJP si vijon: 6 (gjashtë) QSHNJP financohen nga UNDP/ADC në qytetin e Lezhës, Pogradecit, Dibrës, Kukësit, Beratit dhe Elbasanit, kurse 14 (katërmëdhjetë) qendra si: Tirana, Lushnja, Durrësi, Shkodra, Tropoja, Përmeti, Puka, Mati, Kavaja, Kurbin, Gjirokastra, Fieri, Vlorë dhe Korça (financohen nga buxheti i shtetit). Përgjatë vitit 2024 është bërë i mundur kalimi nën administrim si pjesë e strukturës së institucionit të 2 qendrave hapura me mbështetjen e UNDP në Vlorë dhe Korçë (në kuadër të	20 (njëzetë) QSHNJP: Tirana, Lushnja, Durrësi, Shkodra, Tropoja, Përmeti, Puka, Mati, Kavaja, Kurbin, Gjirokastra, Fieri, Vlorë, Korça Lezhë, Pogradec, Dibër, Kukës, Berat dhe Elbasan. Përgjatë vitit 2025, 6 (gjashtë) QSHNJP të cilat financoheshin nga UNDP/ADC financohen gjithashtu nga buxheti i shtetit.

			Këshillit të Qarkut Fier gjatë të cilës u dakordësua Vendosja në dispozicion e (zyrës) në katin e 1 (parë) të Këshillit të Qarkut Fier. Qendra Fier ushtron funksionin pranë Këshillit të Qarkut Fier që prej muajit Shtator 2022. U mundësua lidhja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Bashkinë Gjirokastrë me nr.1105/7 prot., datë 09.06.2022, “Për vendosjen në dispozicion të një ambienti pa kundërshtpërblim në godinën e Pallatit të Sportit Gjirokastrë (godinë nën administrimin e Bashkisë Gjirokastrë). Qendra Gjirokastrë ushtron funksionin pranë Pallatit të Sportit Gjirokastrë që prej muajit Korrik 2022.	<i>Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADA)</i>	<i>marrëveshjes mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADA)</i>	
3	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	11 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë Universitetit ‘Marin Barleti’ dhe Universitetit ‘Luarasi’.	12 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë Universitetit ‘Epoka’.	12 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Përgjatë vitit 2023, pas marrjes dijeni mbi nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit “Aleksandër Xhuvani” dhe Organizatës për	13 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Në Dhjetor 2024 lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.	13 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Në Maj 2025 lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë Universitetit “Albanian University”.

				Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) në Shqipëri, mbi themelimin e Klinikës së Ligjit, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dërgoi shkresën me lëndë: Kërkesë për bashkëpunim, përmes së cilës shprehu interesin mbi mundësinë e bashkëpunimit, përmes nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi me universitetin “Aleksandër Xhuvani”.		
4	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga organizatat jofitimprurëse	12 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2020 (autorizim 2 vjeçar sipas VKM nr. 55/2019).	15 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2022 (3 organizata më shumë se në autorizimi Shtator 2020 të specializuara në fushën e viktimave të dhunës në familje, të miturve, refugjatëve etj.);	15 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2022. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bazë të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, dhe VKM-së Nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të	14 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë për periudhën Tetor 2024-Tetor 2026. <i>Organizata IMZHI fiton autorizim për herë të parë.</i>	14 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë. Kalimi i autorizimit pa afat. me VKM nr.14, datë 09.01.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 55, datë 6.2.2019, të Këshillit të Ministrave” u bë e mundur autorizimi nga periudha 2 vjeçare në pa afat. Përgjatë vitit 2025 janë marrë masa për zgjerimin e numrit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, të cilat ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore.

